

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6081
E premte, 7 gusht 2020
çmimi 0.40 €

10 vjet
nga
vdekja e
Sabit
Veselit,
veprimtar
i çështjes
kombëtare



#NjerëztëPaharrueshëm

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ANALISTËT POLITIKË, SKEPTIKË PËR PROCESIN E DIALOGUT TË BRUKSELIT | FAQE 4-5

MOMENTUMI PREMTUES I DIALOGUT DUKET I IKUR

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se momentum i premtues i dialogut Kosovë - Serbi duket i ikur. Ilir Ibrahim dhe Shkëlzen Maliqi kanë deklaruar se me rënien e interesimit amerikan për dialogun, tanimë këtij procesi i ka humbur rruga. Sipas tyre, rrethanat që kishin ndikuar në dinamizmin e kësaj çështjeje tani shihen me skepticizëm. Ata kanë vlerësuar se procesi i normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi i është kthyer rutinës së vjetër të Brukselit. Skeptik për procesin është shprehur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e cila e ka ftuar qeverinë të heqë dorë nga ky proces dhe të merret me pandeminë



OPINION

SERBËT KANË AFTËSI TË VEÇANTA PËR TË INDOKTRINUAR ME SHPIFJE (25) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

ANULOHEM TESTIN I ARRITSHMËRISË, MASH-I NJOFTON PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E 10-të F. 6

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA E KOSOVËS PARALAJMËRON MARRËVESHJE TË REJA ME SHQIPËRINË F. 6

EKONOMI



THAÇI DEKRETON LIGJIN PËR BUXHETIN, I HAPET RRUGË ZBATIMIT TË PAKOS EMERGJENTE F. 9

MURATI: QEVERIA JOLEGJITIME S'KA NDËRMARRË ASNJË VEPRIM PËR T'I NDIHMUAR BIZNESET F. 9

KATËR ANËTARËT E BORDIT TË KPMM-SË E PËRFUNDOJNË MANDATIN F. 9

VETËVENDOSJA NIS BETEJËN PËR RRËZIMIN E QEVERISË HOTI | FAQE 3



Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje të enjten ka filluar mbledhjen e nënshkrimeve për procedimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Nënkretarja e Kuvendit nga radhët e kësaj lëvizjeje, Arbërie Nagavci, dhe shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Rexhep Selimi, kanë ftuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta mbështesin këtë mocion. Sipas tyre, qeveria Hoti është qeveri ilegale dhe ilegjitime, e cila po e shtyn vendin drejt një katastrofe humanitare. Deri më tani asnjë parti tjetër nuk e ka përkrahur këtë iniciativë

KOSOVË: 16 TË VDEKUR, 134 TË SHËRUAR DHE 196 RASTE TË REJA ME COVID | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

10 vjet nga vdekja e Sabit Veselit, veprimtar i çështjes kombëtare



#NjerëztëPaharrueshëm



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Janë bërë 10 vjet nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare, Sabit Veseli. Me këtë rast, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka cilësuar Veselin frymëzues për gjeneratat e reja si dhe veprimtar për liri dhe pavarësi të Kosovës. “Kohët dhe rrethanat e jashtëzakonshme na takojnë me njerëz të veçantë. Historike ishte rezistenca studentore dhe gjithëpopullore e pranverës 1989. Atëherë në

Prishtinë ndodhi një nga momentet që i dhanë drejtim jetës sime, kur në një prej bazave të organizimit të përpjekjeve për Republikë të Kosovës e takova Sabit Veselin. Sot u bënë 10 vjet nga vdekja e parakohshme e tij. Si veprimtar dhe ish i burgosur politik i viteve '80, Sabit Veseli u bë frymëzues për ne gjeneratat më të reja. Pas daljes nga burgu, ai vazhdoi veprimtarinë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet

në “Facebook”. Sipas Thaçit, Veseli ka thënë kontribut të jashtëzakonshëm për formimin dhe forcimin e UÇK-së. “Unë

dhe Kadriu kemi shumë momente të përbashkëta të aktivitetit me Sabitin dhe ndajmë kujtime të paharruara

në Kosovë dhe diasporë. Sabiti ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për formimin dhe forcimin e UÇK-së. Vdekja e tij ishte një humbje e madhe për familjen, miqtë dhe gjithë bashkëluftëtarët”, ka shkruar Thaçi.

Sabit Veseli është përkujtuar edhe nga lideri i PDK-së, Kadri Veseli, i cili është edhe familjar i tij. Ai ka thënë se Sabit Veseli ka qenë frymëzues dhe mësues i tij në përpjekjet për ta çliruar Kosovën nga pushtuesit. “Sot mbushen dhjetë vjet nga vdekja e njërit prej njerëzve të mi më të shtrenjtë, Sabit Veseli. Ai ka qenë një ndër më meritoret për ditët e lirisë e të pavarësisë që gëzojmë sot, duke kontribuar gjithë jetën si një nga veprimtarët më të guximshëm e të dalluar të çështjes kombëtare. Sabit Veseli për mua nuk ka qenë vetëm një familjar i dashur, por edhe frymëzues e mësues në përpjekjet tona për ta çliruar Kosovën nga pushtuesit. Çdo vit që kalon ma shton mallin për të e m'i forcon kujtimet e bukura të kohëve e zhvillimeve të vrullshme që kemi kaluar bashkë. I paharruar qoftë kujtimi i Sabitit dhe gjithë atyre veprimtarëve të tjerë që punuan gjithë jetën për Kosovën shtet!”, ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në “Facebook”.

Babai i Elizabetës kërkon emrin e vajzës në pllakën përkujtimore



PRISHTINË, 6 GUSHT - Mosvendosja e emrit të Elizabeta Hasanit në pllakën përkujtimore në Mitrovicë, në vendin ku ajo humbi jetën më 13 mars 1999 gjatë një shpërthimi të granatë në tregun e qytetit, për babanë e saj, Rrahimin, është e dhimbshme. “Më dhemb zemra, beso. Duhet të dihet kush është duke pushuar aty. Duhet t'ia vendosin emrin dhe mbiemrin, të dihet kush është duke pushuar, se kështu pa emër, si e panjohur. Kur e ka emrin aty, edhe mua zemra më pushon,

më vjen më lehtë. A kështu po më duket keq, shumë keq”, ka thënë Hasani në një bisedë për “Radion Evropa e Lirë”. Më 13 mars të këtij viti Komuna e Mitrovicës ka zbuluar pllakën përkujtimore për viktimat që pësuan pas shpërthimit në treg në vitin 1999. Aty vdiqën 7 persona dhe u plagosën 128 të tjerë. Në pllakën përkujtimore u shkruan vetëm 6 emra të viktimave shqiptare, por jo edhe emri i shtatë, që ishte vajza 5-vjeçare e një familjeje rome. Nga komuna kanë deklaruar se ky lëshim ka


ndodhur për shkak të mungesës së informatave. Babai i saj, Rrahimi, në atë kohë ishte në Itali. Tash është pensionist dhe jeton në Podgoricë. Pos Elizabetës, gjatë këtij shpërthimi ishte lënduar rëndë edhe vajza tjetër. “Bashkëshortja, e cila ndërkohë ka ndërruar jetë, më ka treguar se ajo ka dashur të blejë djathë dhe i ka lënë fëmijët aty në një qoshe. Njëra vajzë ishte plagosur në të dy këmbët prej asaj bombe, ndërsa Elizabeta ka vdekur në vend”, ka treguar Hasani.

Shqipëria humbet 1.8 miliard euro, tërmeti dhe pandemia gjunjëzoi ekonominë shqiptare

TIRANË, 6 GUSHT - Pandemia Covid-19 ka hapur një gropë të madhe në ekonominë shqiptare ku për vitin 2020 rrezikohet që humbja të shkojë në 1.8 miliard euro. Ky është parashikimi që ka bërë qeveria shqiptare në buxhetin e rishikuar. Të dhënat e Ministrisë së Financave në buxhetin e rishikuar për këtë vit flasin për një ulje të prodhimit të

brendshëm bruto në 12.7 miliardë euro nga 14.5 miliardë euro që ishte në vitin 2019. Këto janë pasojat që pandemia ka lënë në ekonominë shqiptare për shkak të izolimit dymujor dhe pasojave që la në disa hallka të ekonomisë nga ku edhe rënia ekonomike pritet të jetë në 4.3 për qind. Shifrat negative të qeverisë përforcohen nga raportet e institu-

cioneve ndërkombëtare. “Eurostat” ka publikuar statistikën e përditësuar për vendet anëtare ku përfshihen edhe shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Të dhënat flasin për një humbje prej 400 milionë eurosh vetëm në tremujorin e parë të këtij viti ku nuk përfshihet prilli dhe muaji maj ku masat kufizuese ishin edhe më të rrepta.



Lëvizja Vetëvendosje ka nisur mbledhjen e nënshkrimeve për mocion mosbesimi ndaj qeverisë

Vetëvendosja nis betejën për rrëzimin e qeverisë Hoti



Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje të enjten ka filluar mbledhjen e nënshkrimeve për procedimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Nënkryetarja e Kuvendit nga radhët e kësaj lëvizje, Arbërie Nagavci, dhe shefi i grupit parlamentar, Rexhep Selimi, kanë ftuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta mbështesin këtë mocion. Sipas tyre, qeveria Hoti është qeveri ilegale dhe ilegjitime, e cila po e shtynë vendin drejt një katastrofe humanitare. Deri më tani asnjë parti tjetër nuk ka përkrahur këtë iniciativë

19”, ka deklaruar Nagavci. Deputetja e LV-së ka thënë se qeverisë Hoti i mungon edhe plani për rimëkëmbje ekonomike. “Në mungesë të planifikimit për t’u përballur me pandeminë, kjo qeveri e ka kolapsuar sistemin shëndetësor edhe ashtu të brishtë të vendit tonë. Kemi me dhjetëra raste të vdekjeve në ditë. Nuk ka asnjë plan. Po ashtu, nuk ka ndonjë plan për rimëkëmbje ekonomike. Punëtorët, bizneset e pjesa më e madhe e qytetarëve po vazhdojnë t’i vuajnë pasojat e pandemisë”, ka deklaruar ajo. Nagavci ka vlerësuar se kjo përbërje qeveritare po e çon Kosovën drejt një katastrofe humanitare. “Kjo qeveri po e çon vendin drejt një katastrofe humanitare. Ndaloi vettingun, që nënkupton se nuk do gjyqësor të pavarur, sepse nuk do ndryshime, por dëshiron ta vazhdojë avazin. Po ashtu njëjtë veprimi me ndërmarrjet. U shkarkuan bordet e pavarura të emëruara nga qeveria Kurti pa asnjë arsye, për të sjellë njerëz të partive në to”, ka thënë Nagavci. Nagavci ka thënë se 31 vota tashmë veçse i kanë, duke aluduar në numrin e deputetëve që ka LV-ja në Kuvend. Kurse partia tjetër opozitare,

PDK-ja, e cila e ka kritikuar qeverinë Hoti, ka kërkuar sqarime nga LV-ja rreth kësaj iniciative për ta mbështetur. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se fillimisht LV-ja duhet të tregojë se çfarë ka ndodhur që ia ka hequr vijat e kuqe PDK-së dhe sa është serioze në këtë iniciativë. “E para, LV-ja duhet të tregojë se çfarë ndodhi që i paska fshirë vijat e kuqe me PDK-në? E dyta, LV-ja duhet të tregojë sa është serioze në iniciativën për mocionin që e ka nisur në Kuvendin e Kosovës? Nga përvoja e kaluar, ky duket më shumë si një shou politik i radhës sesa një përpjekje e sinqertë. Sepse, votat e LV-së dhe PDK-së nuk mjaftojnë për rrëzimin e qeverisë. Përkundrazi, e shtyjnë këtë qeveri edhe për 6 muaj, sepse ligji thotë që mocioni i mosbesimit mund të ngrehet vetëm një herë në gjashtë muaj”, ka thënë Ismaili. Ndërsa dy partnerët e koalicionit qeverisës, AAK-ja dhe Nisma, kanë deklaruar se nuk do ta përkrahin iniciativën e LV-së. “Gjithmonë opozita e ka detyrë jo vetëm ta kritikojë qeverinë por, po qe se ka mundësi, edhe ta rrëzojë është demokratike. Por, ne si koalicion jemi duke

funksionuar mirë, ndërsa Vetëvendosja e ka të drejtën e vet”, ka deklaruar deputeti i AAK-së, Rasim Selmanaj. Edhe deputeti i Nismës, Endrit Shala, është shprehur kundër mocionit. “Lëvizja Vetëvendosje ka të drejtë të nisë një mocion. Nisma Socialdemokrate është pjesë e këtij koalicioni qeverisës dhe nuk e përkrah një mocion të tillë të ngritur nga Lëvizja Vetëvendosje”, ka deklaruar Shala. Mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë, sipas Kushtetutës, mund të ngrihet mund të propozimin e një të tretës të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Akti më i lartë juridik dhe politik në vend parasheh që mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditë të Kuvendit jo më vonë se pesë ditë e as më herët se dy ditë nga data e parashtrimit të tij. Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Nëse mocioni i mosbesimit dështon, mocioni tjetër i mosbesimit nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë ditëve të ardhshme. Nëse mocioni i mosbesimit votohet për qeverinë në tërësi, qeveria konsiderohet në dorëheqje.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje ka nisur të enjten procedurat për mocion mosbesimi ndaj qeverisë Hoti. Në një konferencë për media, shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se nga kjo ditë do ta nisnin mbledhjen e nënshkrimeve për mocion të mosbesimit ndaj qeverisë. Ai u ka bërë thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit që ta përkrahin këtë nismë. “Ftojme partitë politike që ta mbështesin këtë mocion. Kemi dërguar shkresat ndaj grupeve të caktuara që ta mbështesin

këtë mocion”, ka thënë Selimi. Megjithatë, Selimi nuk ka treguar nëse ndonjëra parti ka treguar përkrahje për mocionin. Kurse nënkryetarja e Kuvendit nga radhët e LV-së, Arbërie Nagavci, ka thënë se qeveria aktuale është jokushtetuese dhe joligjore. “Në anën tjetër kjo qeveri tashmë e ka dëshmuar se është e paafte për ta qeverisur vendin. Edhe pse kur erdhi në pushtet kishim raste minimalisht të reja me virus, madje kishim shënuar edhe zero raste të reja të infektiveve, kur vendi ynë ishte shembull model në botë për menaxhimin e mirë të situatës me pandeminë Covid-

Analistët politikë, skeptikë për procesin e dialogut të Brukselit

Momentum i premtues i

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se momentum i premtues i dialogut Kosovë - Serbi duket i ikur. Ilir Ibrahimimi dhe Shkëlzen Maliqi kanë deklaruar se me rënien e interesit amerikan për dialogun, tanimë këtij procesi i ka humbur rruga. Sipas tyre, rrethanat që kishin ndikuar në dinamizmin e kësaj çështje tani shihen me skepticizëm. Ata kanë vlerësuar se procesi i normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi i është kthyer rutinës së vjetër të Brukselit. Skeptik për procesin është shprehur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e cila e ka ftuar qeverinë të heqë dorë nga ky proces dhe të merret me pandeminë

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se mund të ketë ikur momentum i shumëpërmendur i dialogut Kosovë - Serbi për marrëveshjen përfundimtare. Ilir Ibrahimimi dhe Shkëlzen Maliqi kanë bërë me dije se afrimi i zgjedhjeve presidenciale në ShBA ka ndikuar në rënien e interesit amerikan për këtë proces. Sipas tyre, procesi i dialogut Kosovë - Serbi është rikthyer në dinamikën e mëparshme.

Analisti politik Ilir Ibrahimimi ka deklaruar se nuk është risi që politika e Kosovës nuk ka pasur asnjëherë një qëndrim unik ndaj dialogut dhe se ky proces është shfrytëzuar për luftë të brendshme ndërpartiake për më tepër pushtet sesa për ta shtyrë përpara një çështje të rëndësishme kombëtare. “E gjithë kjo po vazhdon edhe sot, por në një situatë dhe rrethana të tjera, shumë më pak të favorshme për Kosovën, edhe me shumë sfida për klasën politike e cila vazhdon t’i qaset kësaj çështjeje si struci. Sot, kur fushata zgjedhore në ShBA po futet në finalen e saj, është vështirë të pritët një interes çfarë e kemi parë në dy vjetët e fundit. Ky interes do të shkojë duke rënë sa më tepër që i afrohem ditës së zgjedhjeve në nëntor. Brukseli, në anën tjetër, tani kur e arriti atë që gjithmonë synon një zvenitje të rolit të Uashingtonit, por jo edhe ofrimin e një zgjidhjeje të qartë, duket se do t’i kthehet asaj që e bën më së miri - asgjë”, ka shkruar Ibrahimimi në llogarinë e vet në “Facebook”. Sipas tij, me rënien e interesimit amerikan për procesin, dialogu Kosovë -

Serbi ka humbur rrugën. “Ndërkohë, partitë politike i kthehen avazit të vjetër, kritikën ndaj njëri-tjetrit rreth dialogut. Por këtë, si gjithmonë, nuk e bëjnë për një qëndrim më parimor në dialog, por për më tepër pushtet. Në këtë rrugë të humbur vështirë që të gjendet drejtimi më i mirë. Mund të bëhen inskenime dhe aktrime por, përveçse për konsum të brendshëm, vështirë se do të mund të kenë ndonjë rol tjetër. E shoqëria jonë fejsbukiane, e cila po përballet me një krizë pandemike dhe ekonomike të paparë në këtë shekull, do të vazhdojë të japë mendime të mëdha gjeopolitike dhe gjeostrategjike”, është shprehur ai.

Ibrahimimi ka deklaruar se shansi që Kosova e ka pasur në vitet e fundit për ta arritur një marrëveshje me Serbinë nuk është humbur tërësisht. “Vazhdoj të shpresoj (më shumë pak besim) se momentum i shansi që e kemi pasur në 2-3 vjetët e fundit për ta arritur një marrëveshje me Serbinë nuk është humbur tërësisht dhe ai shans do të kthehet prapë pas zgjedhjeve në ShBA. Por edhe më pak besoj se klasa politike e Kosovës do të jetë ndryshe nga ajo që e kemi parë në dy dekadat e fundit dhe do të dijë e do ta shfrytëzojë atë shans (nëse kthehet)”, ka shkruar Ibrahimimi.

Edhe analisti tjetër politik Shkëlzen Maliqi mendon se rrethanat që kishin ndikuar në dinamizmin e kësaj çështje tani shihen me skepticizëm. “E kam fjalën, p. sh., për motivin kryesor të ngutisë, nevojën për vazhdimin e dialogut me Serbinë si prioritet i administratës amerikane, që edhe çoi në largimin e qeverisë

Kurti, e që tani, kur qeveria Hoti korrigjoi lëshimin dhe e hapi dialogun, jemi dëshmitarë se momentum i tij duket i ikur dhe se jemi kthyer në binarët që ky dialogu pati mbetur i bllokuar më parë”, ka thënë Maliqi. Sipas tij, vizita në ShBA e koordinatorit shtetëror për dialog, Skender Hyseni, do të sqarojë shumëçka në këtë drejtim. “Ka dyshime në kapacitetet e qeverisë për ta arritur marrëveshjen finale, por edhe për rrethanat ndërkombëtare që ajo të arrihet. Shkuarja e Skender Hysenit në Uashington ndoshta do t’i sqarojë gjërat dhe ul nervozën, të sqarohemi se e jemi në pikën kritike të marrëveshjes finale, apo të jemi realistë rreth një procesi më afatgjatë. Draftimi i marrëveshjes është proces normal i fillimit të të gjitha marrëveshjeve të rëndësishme. Dhe, një të tillë ka mundur të ketë edhe në takimin e fundit në Bruksel, por ato janë matje e pulsit të të dyja palëve sa janë të gatshme për kompromise eventuale”, është shprehur Maliqi.

Ndër të tjera, ai ka thënë se pas buldozer-demokracisë në tentim të Riçard Grenellit, tani kemi hyrë në një fazë ku ShBA-ja do të jetë aktive, por si faktor i distancuar, jo direkt i negociatave. “Në të vërtetë edhe Granelli pat thënë, pasi që dështoi samiti i Uashingtonit më 27 qershor, se ShBA-ja synon ta mbajë tryezën e negociatave ekonomike, kurse ato politike i takojnë BE-së, meqë Kosova dhe Serbia synojnë integrimin në BE. Kjo strategji nuk është e rastësishme, por e menduar ta eliminojë futjen e Rusisë në negociatë. Nëse ShBA-ja do të ishte pjesë e tryezës me BE-në,



Serbia do ta kërkonte praninë e Rusisë, siç ka qenë formula e tryezave të mëhershme”, ka thënë Maliqi.

Ndërsa menaxherja e projektit në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi, ka kritikuar procesin e rifilluar të dialogut për mungesë të transparencës. Ajo ka thënë për “Epokën e re” se transparenca nuk ka qenë elementi më i fortë i këtij procesi që në fillim. “Duket se mungesa e transparencës është duke e karakterizuar edhe këtë fazë të tij, pavarësisht prej deklaratave të qeverisë se do të jetë transparente rreth dialogut. Është më se e kuptueshme që në proces të negociatave, siç janë edhe këto Kosovë - Serbi, ekziston një masë e konfidencialitetit, por nevoja për transparencë ka të bëjë me qartësimin e procesit, pritshmërinë e palës së Kosovës dhe qasjen që do ta mbajë”, ka thënë ajo. Sipas saj, transparenca në këtë proces

është e nevojshme për ta fituar besimin e shoqërisë. “Lajçaku në vizitën e tij në Kosovë deklaroi se ka një pajtim rreth elementeve të procesit të cilat ende nuk janë bërë publike. Transparenca është e nevojshme për ta fituar edhe mbështetjen dhe besimin e shoqërisë ndaj këtij procesi”, është shprehur Krasniqi.

AShAK-u e KMDLNj: Qeveria ta lërë dialogun, të merret me pandeminë

Skepticizëm për procesin e dialogut të Brukselit kanë shprehur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), të cilat i kanë bërë thirrje qeverisë që ta lërë këtë proces e të fokusohet në menaxhimin e pandemisë. Përmes një komunikate për media, AShAK ka vlerësuar se në këtë situatë të pandemisë Kosova nuk

Ambasadori i ri gjerman: Dialogu me Serbinë është prioritet, jemi përkrah jush

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ambasadori i ri i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka bërë një adresim publik, nëpërmjet të cilit ka shprehur falënderim

për mikpritjen që i është bërë atij bashkë me bashkëshorten në Prishtinë. Me këtë rast, ambasadori Rohde ka shprehur mbështetjen e

pakusht të Gjermanisë për Kosovën, duke përfshirë edhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. “Gjermania është përkrah

jush. Dialogu dhe normalizimi i raporteve me Serbinë është prioritet”, është shprehur ai në videon e publikuar në llogarinë e vet në “Twitter”.



dialogut duket i ikur



duhet ta ketë prioritet dialogun me Serbinë, por tejkalimin e situatës së pandemisë. "AShAK, gjithashtu, konsideron se Kosova në këtë rrethanë nuk e ka prioritet dialogun me Serbinë, sepse ai është duke u përdorur për të mbajtur në pushtet individë dhe politika recidiviste dhe për ta zhvendosur vëmendjen e opinionit në çështje anësore për Kosovën. Kosova nuk e ka asnjë emergjencë të merret me dialogun në rrethana të këtilla dhe nuk ka asnjë arsye që ta bëjë dialogun çështje të preokupimit themelor të institucioneve shtetërore. Të gjitha kapacitetet shtetërore dhe politike duhet t'i përqendrojë në tejkalimin e situatës së pandemisë", është thënë në komunikatën e AShAK-ut.

Kurse KMDLNj ka vlerësuar se, nëse koordinatori shtetëror për dialogun, Skender Hyseni, nuk e ka përkrahjen e opozitës në këtë proces, nuk ka asnjë arsye të bëjë shpenzime të panevojshme. Sipas këtij këshilli, ato mjete të shpenzuara duhet të përdoren në luftë kundër pandemisë. "Qytetarët e Kosovës kanë

nevojë për ruajtje dhe për mbrojtje të shëndetit, skajshmërisht të rrezikuar, për një gjendje ekonomike të përmirësuar dhe të qëndrueshme, kthim në shkolla dhe normalizim të jetës e jo për bisedime të improvizuara, të dëmshme dhe të panevojshme për këtë kohë e që po bëhen për të siguruar një mbijetesë politike apo për t'u rikthyer nga arkivat e mbuluara me pluhur. Të drejtat e njeriut nuk sigurohen e as nuk mbrohen përmes këtyre bisedimeve të ricikluara, por përmes forcimit të institucioneve dhe ligjit që do të ishin vendimtarë për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19", ka vlerësuar këshilli, duke shtuar se procesi i dialogut është një improvizim. "Prandaj, KMDLNj ju thërret t'i lini improvizimet dhe ambiciet personale, politike dhe partiake, e të merreni me probleme reale me të cilat po përballen qytetarët e Kosovës dhe për të cilat edhe keni mandat! Deri më tani keni dështuar në përmbushjen e këtij mandati", ka vlerësuar KMDLNj-ja.

Dialogu Kosovë - Serbi, Palmeri: Shtetet e Bashkuara duan njohje dypalëshe

PRISHTINË, 6 KORRIK - I dërguari i Departamentit Amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka shprehur entuziazëm për rifillimin e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në një bisedë për portalin "Balkan Insider", Palmeri ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara duan të shohin një zgjidhje gjithëpërfshirëse që do t'u shërbejë jo vetëm vendeve në dialog, por gjithë rajonit. "Një zgjidhje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve do të kishte ndikim të madh për stabilitetin në rajon dhe do t'i nxiste të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të integritimit evropian", ka deklaruar ai.

Ai ka vlerësuar se Shtetet e Bashkuara duan njohjen dypalëshe, duke iu kundërvënë zërave se ka pasur diskutime për shkëmbime terriore. "Ne jemi të përqendruar te mbështetja e një procesi të udhëhequr nga BE-ja për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse që çon në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Serbisë dhe Kosovës



që, më idealja, do të kishte në thelb të saj njohjen e ndërsjellët. Ngritja e idesë së shkëmbimit të terrioreve, mendoj unë, e heq vëmendjen

nga synimi qendror, i cili është që palët të ulen, të diskutojnë për këto probleme dhe ta identifikojnë rrugën përpara drejt normalizimit. Ne e

mbështesim këtë proces. Prandaj mendoj se është jashtë teme dhe thjesht shpërqëndruese të diskutohen ide si shkëmbimet territoriale.

Me rëndësi është që palët të ecin përpara për një marrëveshje që sjell zgjidhje përfundimtare", ka deklaruar Palmer.

Quni ndjek nga afër zhvillimin e stërvitjeve fushore të njësiteve të FSK-së



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, së bashku me gjeneralmajor Enver Cikaqin dhe stafin e tij, të enjten kanë ndjekur nga afër zhvillimin e stërvitjes fushore "Kompania në mbrojtje" të realizuar nga kompania "A3" e regjimentit të tretë të forcave tokësore të FSK-

së që është realizuar në zonën e Qyqavicës.

Më tutje, ministri Quni ka vizituar edhe pjesëtarët gjatë demonstrimit praktik të trajnimit "Komando-Bereta", që është duke u realizuar në zonën e fshatit Ceceli të Komunës së Vushtrrisë. Për zhvillimin, objektivat e synuara të stërvitjes

dhe trajnimit përkatës si dhe kapacitetet njerëzore e teknike të angazhuara, ministrin Quni e ka njoftuar komandanti i komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral Fadil Hadërgjonaj.

Nga ana e tij, ministri Quni ka përgëzuar KFT-në, duke vlerësuar lart angazhimin edhe

në këtë kohë të përbaljes me krizën pandemike. "Unë kam marrë raportet e përditshme të punës dhe angazhimit tuaj dhe jam i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar gjatë kësaj periudhe, por me moral të lartë, kalitje fizike dhe shkathtësitë e duhura profesionale keni arritur t'i

përbaltoni me sukses" ka thënë Quni.

Trajnimit "Komando-Bereta" është duke vijuar dhe është trajnim në kuadër të planit vjetor të trajnimeve sipas planit të tranzicionit për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen territoriale të vendit.

Zëvendëskryeministrja e Kosovës paralajmëron marrëveshje të reja me Shqipërinë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, ka mbledhur të enjten Këshillin Organizativ për përgatitjen e marrëveshjeve të cilat do të nënshkruhen në mbledhjen e radhës në mes të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. Balaj-Halimaj ka thënë se krahas marrëveshjeve të reja, fokusi do të jetë në evidentimin e të gjitha pengesave dhe shtyrjen përpara të marrëveshjeve të arritura më herët dhe të cilat nuk po gjejnë zbatim në praktikë. "Takim jashtëzakonisht i frytshëm i Këshillit Organizativ për përgatitjen e marrëveshjeve të cilat do të nënshkruhen në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në mbledhjen e ardhshme të dy qeverive, e


cila do të mbahet në muajin shtator. Krahas marrëveshjeve të reja, fokusi ynë do të jetë në funksion të evidentimit të të gjitha pengesave dhe shtyrjen përpara të marrëveshjeve të arritura më herët dhe të cilat nuk po gjejnë zbatim në praktikë. Për mbledhjen e radhës janë disa marrëveshje të cilat planifikojmë të nënshkruhen mes dy qeverive të cilat kanë për objektivi rritjen e mirëqenies, lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve dhe mallrave andej e këndej kufirit", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Facebook".

Zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj është koordinatore e Qeverisë së Kosovës për përgatitjen e mbledhjes mes dy qeverive.



Anulohet testi i arritshmërisë, MASH-i njofton për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, ka marrë vendim për anulimin e testit të arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta. Vendimi është marrë për shkak të gjendjes së rënduar me Covid-19, "marrë parasysh gjendjen nëpër të cilën është duke kaluar vendi ynë si pasojë e pandemisë Covid-19, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të nxënësve, mësimdhënësve, personelit të institucioneve arsimore dhe gjithë qytetarëve u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi", është thënë në arsyetimin e MASH-it. Me këtë rast, MASH-i ka treguar kushtet dhe kriteret për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të të vitit shkollor 2020/21, pas anulimit të testit të arritshmërisë. Në këtë kontekst, është bërë me dije se shpallja e konkursit për pranimin e nxënësve në klasën e 10-të do të bëhet më 17 gusht nga Drejtoritë



Komunale të Arsimit (DKA), ndërsa dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet deri më 21 gusht. Sipas njoftimit të MASH-it, publikimi i rezultateve do të bëhet më 24 gusht.

Rritet numri i personave të vdekur nga koronavirusi në Kosovë

Kosovë: 16 të vdekur, 134 të shëruar dhe 196 raste të reja me Covid

Brenda 24 orëve në Kosovë kanë ndërruar jetë 16 persona pas infektimit me Covid. Me këta të fundit, ka shkuar në 300 numri i përgjithshëm i viktimave nga ky virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se janë paraqitur edhe 196 raste të reja me koronavirus si dhe janë shëruar 134 persona. Sipas IKShPK-së, numri i përgjithshëm i të infektuarve me virusin Korona ka shkruar 9 688, kurse i të shëruarve 5 480

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 6 gusht - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë vdekur 16 persona të prekur nga Covid-19. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se janë shëruar 134 persona dhe janë paraqitur 196 raste të reja. "Numri total i rasteve pozitive është 9 688 raste nga 39 278 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 300 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 134 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 5 480 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 908", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtruar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të reja me koronavirus. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 45 raste, komuna Pejë 20 raste, komuna Ferizaj 15 raste, komuna Gjakovë 12 raste, komuna Podujevë 12 raste, komuna Gjiilan 10 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Prizren 9 raste, komuna Mitrovicë 8 raste, komuna Vushtrri 8 raste, komuna

Malishevë 6 raste, komuna Suharekë 6 raste, komuna Viti 6 raste, komuna Deçan 5 raste, komuna Istog 4 raste, komuna Kaçanik 4 raste, komuna Dragash 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Kamenicë, Klinë, Obiliq dhe Skenderaj", ka njoftuar ky institut. Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është

kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusit vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe

shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmeve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventuale të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut. Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

Lufta kundër Covidit, Zemaj viziton spitalin e Ferizajt

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të enjten spitalin rajonal të Ferizajt. Me këtë rast, ai ka thënë se lufta kundër Covid-19 është duke u shtuar. Në këtë kontakt, Zemaj ka theksuar se janë duke u angazhuar që në çdo spital rajonal t'i rrisin kapacitetet teknike dhe humane! "Sot vizitova spitalin Rajonal të Ferizajt për t'i parë kapacitetet dhe nevojat e stafit mjekësor. Dje kjo komunë është ndihmuar nga Ministria e Shëndetësisë me 24 000 maska, 900 palë veshje mbrojtëse dhe 990 dezinfektues. Ndërsa sot kemi dorëzuar 2 respiratorë dhe një autoambulancë, e cila do ta lehtësojë sadopak punën e stafit mjekësor dhe do ta rrisë cilësinë e shërbimeve për qytetarë. Përveç kësaj, në konkursin për shkollim specialistik, për kandidatët nga Komuna e Ferizajt janë ndarë 22 vende. Të gjithë këta specializantë do të shërbejnë në këtë komunë, duke i dalë në ndihmë kështu stafit mjekësor aktual, i cili tash e sa muaj po bën punë sublime!", ka thënë Zemaj.

Kadri Veseli shërohet nga Covid-19

Pas qëndrimit në izolim, sipas udhëzimeve të mjekëve dhe rekomandimeve të IKShPK-së, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, është kthyer për punët e përditshme në parti, pasi është shëruar nga Covid-19. Me këtë rast, Veseli ka falënderuar qytetarët, anëtarët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe miqtë e shumtë që kanë telefonuar dhe kujdesur n për të gjatë kësaj periudhe. "Faleminderit të gjithëve që më qëndruat afër gjatë kësaj kohe. Nuk kam pasur simptoma të rënda, por nuk ishte edhe situatë e lehtë izolimi. Shfrytëzoj rastin të kërkoj nga ju që t'i mbani maskat, ta ruani distancën dhe t'i pastroni duart sa më shpesh për ta ruajtur veten dhe të tjerët nga kjo sëmundje", ka thënë Veseli.

Thaçi: Mantelbardhët janë heronjtë e betejës kundër pandemisë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar mjekët që kanë humbur jetën nga Covid-19 në vendin tonë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se mantelbardhët janë heronjtë e betejës kundër pandemisë. "Ishin gjithnjë në shërbim të qytetarëve, duke u kujdesur për

lehtësimin e dhimbjeve dhe shërimin e tyre. Por, në përballje me Covid-19 humbën jetën. Mantelbardhët janë heronjtë e betejës kundër pandemisë. Kujtimi për Fadilin, Aliun, Sylejmanin, Lulzimin, Kujtimin dhe për çdo qytetar që humbi jetën në këtë betejë do të jetë i përjetshëm", ka shkruar Thaçi.



Murati: Qeveria jolegjitime s'ka ndërmarrë asnjë veprim për t'i ndihmuar bizneset

Deputetët e Kuvendit pritet ta trajtojnë Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, i cili është hartuar nga qeveria Hoti. Opozita dhe njohës të çështjeve ekonomike janë duke e parë me skepticizëm këtë projektligj. Deputeti i Vetëvendosjes, Hekuran Murati, ka thënë për "Epokën e re" se projektligj në fjalë nuk reflekton as emrin e tij. Ndërsa sa i përket rimëkëmbjes ekonomike, Murati ka thënë se deri më tani qeveri Hoti, të cilën e ka quajtur jolegjitime, nuk ka bërë asnjë veprim për t'u dalë në ndihmë bizneseve. Ndërsa njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se partitë politike nuk janë të interesuara për rimëkëmbjen ekonomike të vendit



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kuvendi i Kosovës sot (e premte) pritet ta shqyrtojë Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Transfere nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka vlerësuar se një projektligj i tillë nuk reflekton emërtimin e tij. Ai ka thënë për "Epokën e re" se me një projektligj të tillë nuk mund të ketë rimëkëmbje ekonomike. "Projektligji në fjalë ka mungesa të theksuara në përmbajtje dhe as për së afërmi nuk reflekton

emërtimin e vet ligjit. Pra, me këtë projektligj nuk mund të ketë rimëkëmbje ekonomike siç është proklamuar që sa kohë. Ne si Lëvizje Vetëvendosje do të përpiqemi që përmes amendamentit, së paku t'i përmirësojmë disa gjëra në mënyrë t'u ndihmohet sa më shumë qytetarëve dhe bizneseve", ka deklaruar Murati.

Ai ka thënë se deri më tani qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti nuk ka marrë asnjë veprim për t'u dalë në ndihmë bizneseve. Në këtë kontekst, Murati ka thënë se, edhe nëse miratohet ky projektligj, nuk do të ketë ndonjë ndryshim sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. "Deri tani nga kjo qeveri

jolegjitime nuk është se kemi parë ndonjë veprim apo masë që ka qenë e dedikuar t'u vijë në ndihmë bizneseve, shtu këtu edhe dështimin për ta përbushur pakon e emergjente të nisur nga qeveria Kurti. Tek tani në Kuvend ka ardhur projektligji i emërtuar për rimëkëmbje ekonomike, por as aty nuk vërehet se ka ndonjë masë konkrete, me përjashtim të sektorit të gastronomisë. Mirëpo ekonomia është shumë më tepër se kaq. Dhe rrjedhimisht, ky projektligj, edhe nëse miratohet, nuk do të përbëjë ndonjë ndryshim sa i përket ekonomisë dhe rimëkëmbjes nga pandemia", është shprehur Murati. Në lidhje me Projektligjin për

parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës ka folur edhe njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë për "Epokën e re" se Kosova është duke u përballur me probleme të shumta të natyrës ekonomike. Në këtë kontekst, Gërxhaliu ka thënë se gjuha denigruese që është duke u përdorur në seanca plenare është demotivuese. "Kosova është duke u përballur me probleme të shumta të natyrës ekonomike dhe sociale, por më së shumti kjo situatë është duke e goditur sektorin privat. Dhe gjuha denigruese që përdoret nëpër seanca është me të vërtetë demotivuese, pasi aty duhet

të punohet dhe të na jepet arsye për të shpresuar. Vetë fakti që e kemi një dallueshmëri të lartë të partive politike, na tregon në çfarë niveli jemi. Kam drojën që shumë më shumë po mbrohen interesat e grupeve të caktuara sesa të sektorit privat", është shprehur Gërxhaliu, duke shtuar se partitë politike nuk janë të interesuara për daljen e Kosovës nga kriza ekonomike. "Është e vërtetë që në seancë do të ketë debat, porse nuk pritet diçka produktive, pasi aty ka më shumë ofendime dhe sharje. Fokusi është në mbledhjen e nënshkrimeve për rënje të qeverisë, e jo për rimëkëmbje dhe dalje nga kriza", ka thënë Gërxhaliu.

Dy drejtorë të Postës kacafyten dhe fjalosen në mes vete



PRISHTINË, 6 GUSHT - Dy drejtorë të menaxhmentit të lartë të Postës së Kosovës janë kacafytur në objektin kryesor të kësaj ndërmarrje. Këtë ndodhi e ka konfirmuar edhe vetë Posta e Kosovës. "Sot paradite në objektin e administratës qendrore të Postës së

Kosovës ka ndodhur një incident i vogël i fjalosjes dhe kacafytjes në mes të dy drejtorëve të menaxhmentit të ndërmarrjes", ka njoftuar Posta. Menaxhmenti i Postës ka deklaruar se për këtë rast janë duke u marrë organet e rendit, ndërsa dy drejtorët janë duke u

intervistuar në Policinë e Kosovës në Prishtinë. "Menaxhmenti i ndërmarrjes do t'i ndërmarrë masat disiplinore gjatë ditëve në vijim, sipas rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes dhe ligjeve në fuqi", ka njoftuar Posta. (A. Mavraj)

KRU "Prishtina" bën thirrje për pagesën e faturave

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i paguajnë faturat e rregullta mujore për shpenzimin e ujit. "Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Prishtina' sh. a. qëllimin kryesor e ka ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm

për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit. Për ta përbushur këtë mision me sukses dhe për të ofruar furnizim stabil me ujë të pijshëm dhe cilësor, sigurisht se kërkohet angazhim maksimal dhe ka kosto të lartë në trajtimin e ujit dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në

vazhdimësi. Në mënyrë që t'ju ofrohet ky shërbim cilësor, kërkohet nga ju që ta përbushni obligimin tuaj ndaj pagesës së faturave të rregullta mujore për shpenzimin e ujit. Paguani faturat e ujit, mos lejoni grumbullimin e borxhit!", është thënë në apelin e KRU "Prishtina".



Katër anëtarët e bordit të KPMM-së e përfundojnë mandatin

Kryesuesit të bordit të KPMM-së, Musa Shabani dhe anëtarëve Azem Rexhaj, Kemajl Zeqiri dhe Festim Kutlovci u ka përfunduar mandati. Bordit, i cili ka përbërje prej pesë anëtarësh, tashmë i ka mbetur vetëm një me mandat dhe rrjedhimisht është pa vendim-marrje. Me këtë rast, KPMM-ja ka njoftuar se është hapur konkursi për plotësimin e katër pozitave të lira



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 GUSHT - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka bërë me dije se kryesuesi i bordit i këtij komisioni, Musa Shabani, ka përfunduar mandatin. Po ashtu, KPMM-ja ka bërë me dije se mandatin e kanë përfunduar edhe anëtarët Azem Rexhaj, Kemajl Zeqiri dhe Festim Kutlovci, ndërsa anëtarit tjetër, Avdi Konjuhi, ka mandat deri në mars të vitit 2021. "Gjatë periudhës pesëvjeçare anëtarët e bordit, si pjesëmarrës në udhëheqjen e KPMM-së, kanë treguar një performancë të lartë në zbatimin e politikave/strategjive në sektorin mineral si dhe në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë në përputhshmëri me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Gjithashtu, bordi i KPMM-së ka marrë pjesë në

takime të ndryshme jashtë vendit si dhe të brendshme, në takime ndër-institucionale, konferenca, takime këto të cilat kanë rezultuar të suksesshme për Komisionin e Pavarur të Minerave dhe Mineraleve si institucion, si dhe për aspekte ekonomike në nivel të vendit", ka njoftuar KPMM-ja.

Sipas KPMM-së, në periudhën sa ishin të pranishëm si pjesë e bordit të KPMM-së janë lëshuar gjithsej 1 093 licenca dhe leje, nga të cilat 463 janë licenca të hulumtimit, 231 licenca të shfrytëzimit si dhe 399 janë leje për aktivitete të veçanta.

Drejtori i KPMM-së ka njoftuar bordin se është shpallur konkursi për anëtarë të ri të bordit nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 28 korrik 2020. "Në bazë të procedurave ligjore për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit nuk

parashihet që bordi i ri të vijë brenda këtij muaji. Kjo nënkupton që KPMM-ja do të mbetet pa bord dhe pa mundësi të marrjes së vendimeve, sidomos të dhënies së licencave dhe lejeve për një afat të pacaktuar deri në zgjedhjen e bordit të ri. Në takimin e fundit të bordit, bordi u pajtua me konstatimin e drejtorit të KPMM-së, se KPMM-ja do të mbetet për një

kohë pa bord dhe pa mundësi të marrjes së vendimeve për shkak të mungesës së kuorumit, si dhe KPMM-ja të do të ngecë për çështje administrative. Pasi analizoi praktikën e mëhershme në KPMM, bordi ishte i pajtimt që të marrë vendim bazuar në praktikën e bordit të KPMM-së të vitit 2014, me ç'rast bordi kishte marrë vendim për caktim të ushtruesit të detyrës së krye-

suesit. Bazuar në këtë, bordi mori vendim që në përputhje me nenin 59, pika 1 dhe nenin 62 të LMM-së, ta caktojë u. d. të kryesuesit Avdi Konjuh. U. d. i kryesuesit do ta ushtrojë detyrën e kryesuesit deri në caktimin e kryesuesit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës", ka njoftuar KPMM-ja. Anëtarët e KPMM-së për punën e vet i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.

Thaçi dekreton Ligjin për buxhetin, i hapet rrugë zbatimit të pakos emergjente



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekretuar Ligjin për buxhetin dhe plotësim/ndryshimet e tij të cilin e ka pranuar nga Kuvendi të mërkurën pasdite. Ai ka deklaruar se e ka bërë dekretimin e menjëhershëm në mënyrë që sa më parë të ekzekutohen pagesat për qytetarët dhe të zbuten pasojat e pandemisë. "Sapo dekretova Ligjin për buxhetin dhe plotësim/ndryshimet e tij, të cilin e kam pranuar dje pasdite. E bëra dekretimin e menjëhershëm që sa më parë të ekzekutohen pagesat për qytetarët tanë dhe të zbuten pasojat e pandemisë. Jam i vetëdijshëm për shqetësimet e ngritura nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, por hyrja në fuqi e këtij ligji është domosdoshmëri urgjente për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve. Ekzekutivi i vendit jam i bindur se do të gjejë

hapësirë dhe mundësi për t'i trajtuar të gjitha shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesit sektorialë. Por, prioritet dhe qëllim i përbashkët i të gjithë neve është lehtësimi i pasojave të pandemisë dhe menaxhimi sa më i mirë i kësaj situate", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".


Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se Ministria e Financave është duke bërë përgatitjet e duhura për t'iu bërë pagesat ndaj punëtorëve dhe bizneseve. "Përmes Ministrisë së Financave dhe ministrive të linjës po bëjmë përgatitjet për pagesat për punëtorët e mbetur të papunë, qiratë e ndërmarrjeve dhe familjet pa të ardhura. Gjithashtu, po bëjmë planin e shpërndarjes së mjeteve për masat e rimëkëmbjes ekonomike, i cili plan do të miratohet në qeveri së shpejti", ka njoftuar Hoti nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook".

Komunat, të gatshme për ofrimin e shërbimeve për marrjen e terapisë parenterale për pacientë me Covid-19

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Drejtoritë komunale të shëndetësisë janë përballur me vështirësi të shumta për përbushjen e kërkesave dhe për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mbrojtje nga Covid-19. Me qëllim të shqyrtimit të gjendjes së pandemisë Covid-19 në komunat e Kosovës, Kolegjiumi i Shëndetësisë ka diskutuar për sfidat me të cilat ballafaqohet gjatë angazhimit në terren dhe për problematikat e hasura në luftimin e pandemisë. "Për shkak të rritjes së numrit të infektuarve me Covid-19, komunat po ballafaqohen me kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve për ofrimin e shërbimeve për marrjen e terapisë parenterale te Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Edhe pse nuk parashihet në konceptin e mjekësisë familjare, komunat

angazhohen për tejkalimin e kësaj situate, ku edhe kanë marrë përgjegjësinë për ofrimin e kësaj terapie në të mirë të pacientëve. Pavarësisht ngarkesave dhe kapaciteteve të limituara për dhënie të kësaj terapie, komunat kanë ndërmarrë nismat për përcaktimin e një qendre të veçantë e cila do të ishte në funksion të trajtimit dhe për ofrimin e kësaj terapie. Një nismë e tillë është ndërmarrë pas shtimit të vizitave nga pacientë me Covid-19, e të cilët referohen nga niveli sekondar apo terciar shëndetësor", ka njoftuar Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Po për këtë qëllim drejtoritë komunale të shëndetësisë kanë formuar ekipe për vizita familjare në ofrimin e kësaj terapie në mënyrë që pacientët të mos shëtiten në qendra të ndryshme nga



identifikimi i rasteve deri te trajtimi dhe ofrimi i shërbimeve parenterale. "Një ndër problematikat e shfaqura ishte edhe ajo e mungesës së oksigjenit në institucionet shëndetësore, andaj një shqetësim i tillë duhet të adresohet dhe të merret seriozisht nga Ministria e

Shëndetësisë. Sa i përket bashkëpunimit me nivelin qendror, ajo mbetet hallka kryesore gjatë këshillimit dhe ndërmarrjes së masave dhe vendimeve në lidhje me masat parandaluese që do të merren në të ardhmen", ka njoftuar AKK-ja. Me këtë rast, kryesuesi i Kolegjiumit i Shëndetësisë,

Bujar Gashi, ka premtuar se shumë shpejt do t'i adresojnë shqetësimet dhe kërkesat e komunave të Kosovës te Ministria e Shëndetësisë me qëllim të koordinimit më të mirë me nivelin qendror për vendimet dhe masat e ndërmarrja në menaxhimin e pandemisë.

Veliu dhe Abrashi premtojnë mbështetje për Istogun



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu dhe ai i Infrastrukturës, Arban Abrashi, kanë vizituar Komunën e Istogut, me ç'rast janë njoftuar me problemet që po e përcjellin këtë komunë.

Kryetari i Istogut, Haki Rugova, ka thënë se janë pajtuar që problemet me pandeminë Covid-19 të jenë ndër prioritetet e tyre. "Biseduam gjerë e gjatë për problemet rreth pandemisë

Covid-19, ku MPB-ja ka një rol të veçantë. Kemi biseduar edhe për probleme të tjera që ndërlidhen me administratë publike dhe ministri Veliu e dha premtimin e vet që problemet që i kemi shumë shpejt të tejkalohej. Sigurisht se edhe në infrastrukturë kemi disa marrëveshje të nënshkruara me ministrin Abrashi për projekte në infrastrukturë në Komunën e Istogut dhe janë disa të tjera që do të fillojnë shumë shpejt. Jam i sigurt që me një

bashkëpunim të mirë do t'i tejkalojmë", ka thënë Rugova. Ndërsa ministri Veliu ka thënë se menjëherë pas aktivizimit të planit të reagimit kombëtar ka filluar një cikël të vizitave nëpër komuna dhe kjo është vizita e parë, ku do të njoftohet se si po zbatohen masat sa i takon pandemisë Covid-19. Në anën tjetër, ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka premtuar se shumë shpejt do të nisnin dy projekte madhore infrastrukturore.

FSK-ja rregullon oborrin e dy shkollave në Drenas

DRENAS, 6 GUSHT (ER) - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Zenel Hajdini" në Tërstenik dhe ShFMU "Dëshmorët e Fortesës" në Vërboc janë përfitues të projektit nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). FSK-ja në mënyrë vullnetare në ambientin e këtyre dy objekteve shkollore ka bërë rregullimin e oborreve.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka, ka falënderuar gjeneralin e FSK-së, Xhevahir Geci, zëvendësministren e Ministrisë së Mbrojtjes, Sadika Kofrc, Komandantin e Regjimentit të Xhenios, Rifat Maloku dhe stafin e FSK-së që kanë kontribuar në rregullimin e oborrit të këtyre dy shkollave. Gjoka ka vlerësuar se rregullimi i oborreve të këtyre dy shkollave do të ndihmojë në përmirësimin e infrastrukturës shkollore.



SERBËT KANË AFTËSI TË VEÇANTA PËR TË INDOKTRINUAR ME SHPIFJE (25)



Shkruan: Kudusi LAMA

Dihet, askush nga udhëheqësit e luftës çlirimtare nuk duhet lënë pa pjesë të ardhurash financiare në rrugë kriminale. Kështu që nuk mund të lihet pa pjesë edhe Xhavit Haliti si ideolog dhe udhëheqës i spikatur i luftës për çlirimin e Kosovës. Ndaj unë nuk habitem që edhe atij ia kanë gjetur dikë, për të bashkëpunuar që të fitojë të ardhura, që nuk dihet pse i përdorë, por që tani për tani akoma nuk ia kanë gjetur vendin se ku i mban paratë, veçse ia kanë gjetur bashkëpunëtorët.

Sa të lehtë e ka pasur zotëri Marty ta përpilojë raportin për Evropën? Sa të mbushur e ka agjendën kriminale duke u mbështetur në shpifjet dhe akuzat e Serbisë? Por a do të mund ta mbrojë këtë raport tani që u themelua tribunali për krimet e luftës së UÇK-së? Në këtë moment më kujtohet libri i presidentit Bill Clinton "Jeta ime", botuar pas dorëzimit të detyrës së presidentit të ShBA-së. Ai në librin e tij, ndër të tjera, trajton edhe çështjen e emërimit të prokurorit të pavarur për hetimin e presidentit të ShBA-së. Unë përmbledhtas do të bëj një pasqyrë të asaj që shkruan presidenti Bill Clinton: "Kur mora detyrën e presidentit, - tregon ai - Partia Republikane, meqenëse kisha qenë për rreth 16 vjet në detyra shtetërore i zgjedhur me votat e popullit, kishite krijuar mendimin se unë diku duhet të isha korruptuar, ndaj kërkoj që të emërohej një prokuror i pavarur për të hetuar presidentin. Unë - thotë Bill Clinton - duke marrë në analizë veprimtarinë time dhe duke ditur se kisha punuar me ndershmëri, e bëra dekretimin e këtij prokurori të pavarur për të hetuar presidentin, por duket se bëra gabimin më fatal të jetës time, pasi: ky prokuror i pavarur, për 8 vjet, përveç që shpenzoi mbi 65 milion dollarë të taksapaguesve amerikanë, për 8 vjet më nxiu jetën mua dhe familjes time, mori nën hetim të gjithë njerëzit që kishin pasur fatin e keq në jetë që më kishin njohur mua, kishin qëndruar apo kishin pirë një kafe me mua, të cilët i trajtoi me një presion të madh për të treguar çfarë dinin për jetën time. Ashtu sikurse burgosi katër persona,

(presidenti Clinton u përmend edhe emrat) vetëm pse nuk kishin pranuar të firmosnin deklaratat që u kishte vënë përpara për të firmosur, në të cilat shpifej kundër presidentit".

E tregova këtë episod, që të kuptojnë të gjithë luftëtarët dhe udhëheqësit e komandantët e UÇK-së e të luftës çlirimtare të Kosovës, se edhe ky tribunali i pranuar politikisht nga Kosova, do të jetë e do të veprojë si ai prokurori i pavarur që hetoi presidentin Clinton, do të persekutojë e keqtrajtojë shumë njerëz sidomos pjesëmarrës të luftës, pse nuk do të shpifin kundër komandantëve të tyre, që Serbia do t'i njollosë, sepse ajo me shpifjet e saj i ka njollosur me kohë, por në fund e vërteta ka për të qenë madhështore ashtu siç ka qenë madhështore Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e saj.

"Familja Kitaj është grupi kriminal udhëheqës, që kontrollon zonën ndërmjet Klinës dhe Istogut. Është e shkathët në kontrabandën e automjeteve të vjedhura dhe në shitjen e lëndëve plasëse në Kosovë - Metohi".¹ Besoj nuk çuditet askush që nuk lihet asnjë pëllëmbë e tokës së Kosovës pa u mbuluar me rrjet kriminal nga më monstruoze. Kjo nuk bëhet pa qëllim. Edhe atje ku nuk ka emra që duhen goditur duhet të ketë patjetër krim të organizuar, këtë objektiv ka vënë Serbia dhe përdorë të gjitha mjetet për ta bërë sa më të besueshëm, sepse gjithkush e në radhë të parë Evropa dhe populli shqiptar duhet të binden se Kosova nuk mund të ketë të ardhme pa Serbinë. Se pa Serbinë Kosova nuk mund të zhvillohet, se e mbyti krimi e kriminelët, se është e destabilizuar dhe se askush nuk mendon për të mirën e saj veç Serbisë.

"Klani kriminal Suma vepron në zonën e Kaçanikut. Krahas reketimit dhe shantazhit, merret me kontrabandën e armëve dhe të drogës nga Maqedonia në Kosovë - Metohi e anasjelltas. Anëtarët e klanit Suma janë të lidhur me grupin që udhëheq Rrustem Mustafa, i quajtur "Remi" nga Podujeva".² Nuk mund të lihet pa iu vënë emri edhe Kaçanikut, pasi andej kalon rruga për në Maqedoni dhe patjetër që edhe atje meqë ka rrugë duhet të ketë edhe krim edhe kriminelë. Dhe janë shpifje të tilla që mjaftë djem të luftës kanë vuajtur deri sot e do të vuajnë edhe më tej, deri kur të ndërjegjësohen evropianët e ndershëm, (jo zotëri Marty se ai



është i ndërgjegjësuar plotësisht por është me mision) e t'i thonë Serbisë dhe gjithë atyre që abuzojnë me shpifje të tilla - mjaft më. Që ky moment do të vijë këtë unë e di mirë dhe dua të jenë të bindur të gjithë shqiptarët, por deri kur të vijë ky moment djemtë e luftës do të na i lodhin pikërisht me shfaqje të tilla monstruoze. "Klani Sylja bashkërendon zinxhirin e krimin të organizuar, që vepron në territorin e Kosovës - Metohisë dhe të Maqedonisë, në planin e importit ilegal të armëve, municioneve e pajisjeve të tjera".³

Bile unë mendoj se Klanit Sylja i kanë lënë pak hapësirë. Vetëm ka një gabim të vogël, ai nuk është klan, por rrjet kombëtar, që do të qëndroj gjithmonë i freskët, për të mos e lejuar Serbinë të bëjë çfarë do. Veçse jo me kriminalitet, siç e vesh Serbia por me veprimtari kombëtare në paqe e në luftë, për të mos lënë asnjë pëllëmbë tokë shqiptare nën sundimin skllavërues e kolonizues të Serbisë. Mua nuk më impresionon fare mënyra se si flet Serbia, por më shqetëson fakti që në Evropë ka akoma njerëz të veshur edhe me pushtet politik që i marrin seriozisht ato që thotë Serbia, deri kur ta kuptojnë se ajo mashtron dhe ka mbetur në politikën mesjetare.

"Anëtarët e familjes Agushi veprojnë në zonën e Klinës. Merren me shantazhin e parave nga shqiptarët, të cilët janë kërcënuar me dhunë të mbledhin paraprakisht pronat dhe pasuritë serbe të grabitura në komunën e lartpërmendur, si dhe me shantazhin e blerësve potencial".⁴ A ka tjetër zonë që duhet përgojuar? Të gjithë lexuesit duhet të nxjerrin vetë konkluzione për të vlerësuar banalitetin e të gjitha deklarimeve të Serbisë e të zotit Marty.

Nga sa shkruhet duket sikur në Kosovë nuk bëhet asnjë punë prej kur aty nuk sundon Serbia. A ka njeri të paktën ndër

shqiptarët që e beson një gjë të tillë? Unë besoj se çdo shqiptar ka fuqinë të japë përgjigjen e duhur për të gjitha shpifjet që vihen në evidencën e këtyre deklarimeve serbe dhe të rinovuara prej zotit Marty.

"Klani Geci është aktivizuar në zonën e komunës së Pejës, Mitrovicës, Serbicës dhe Prishtinës. Merret me kontrabandën e benzinës dhe bashkëpunon me Xhevat Halitin dhe familjen Selimi".⁵ Lidhje të çuditshme, që askush me arsye të shëndoshë nuk arrin t'i asimilohet. Sidoqoftë, Serbia duke bërë këto arsytetime shpifëse ka arritur të krijojë një mjegullnajë që t'i bëjë me dyshim të gjithë ata që nuk e njohin gjendjen. Dhe qëllimi i saj ndoshta është edhe ky, që të gjithë të painformuarit të marrin kallëp çfarë thotë Serbia dhe t'i konsiderojnë të vërteta duke paragjykuar djemtë e luftës, që realisht unë kam konstatuar edhe se ka të tillë të pa informuar në hapësirat shqiptare.

Serbët me shpifjet luajnë fortë. Unë kam konstatuar se ata kanë aftësi të veçanta për të indoktrinuar me shpifje, jo vetëm qytetarët e zakonshëm, por edhe intelektualët e njohur e shkencëtarët. Prandaj mos të na duket i çuditshëm fakti që serbët kur bëjnë shpifjet kundërshqiptare i ndërtojnë në mënyrë të tillë që të jenë sa më të besueshme. Ata nuk harxhojnë kohë dhe mund e vlera monetare për t'i harxhuar, por për të marrë efektivitetin e tyre, ne e dimë se ata këtë mjeshtri e kanë mjaft të zhvilluar. Prandaj edhe duhet të gjejmë mënyrat më të sofistikuara për demontimin e tyre e për t'u hapur sytë jo vetëm shqiptarëve të indoktrinuar, por edhe evropianëve me fakte e me forcë argumenti, që të mund të shohin shpifjet e t'i ndajnë nga të vërtetat. Ne për këtë punojmë pak, prandaj edhe serbët zbatojnë atë thënien e kurvës: "mbama nën kopilin, t'i them asaj para se të më thotë". "Klani Babalia vepron në zonën e Gjakovës është në

bashkëpunim me Ramush Haradinajn dhe merret me kontrabandën e benzinës nga Shqipëria dhe me tregtinë ilegale të narkotikëve".⁶ Ramushi tashmë ia ka treguar vendin Serbisë, i ka arsyetuar të gjitha veprimet e veta. Do të vijë dita që të gjithë do të vijnë nga përballja gjyqësore ashtu si Ramushi e Fatmiri dhe do t'i tregojnë vendin Serbisë dhe të gjithë Dick Martëve të saj. "Nga mesi i viteve '90-të, kriminelët shqiptarë nga ShBA kishin filluar të ndihmonin UÇK-në në Kosovë - Metohi me grumbullimin e mjeteve financiare, me të cilat u blenë armë për nevojat e këtyre organizatave terroriste. Grumbullimi i mjeteve, në fillim, ishte kryer fshehurazi, kurse më vonë edhe në ShBA ishte e hapur filjalja e fondit "Atdheu thërret" i cili, nëpërmjet llogarive bankare në SHBA, Kanada dhe në shumë vende evropiano-perëndimore, ua drejtonte mjetet financiare pjesëtarëve të UÇK-së. Krahas kësaj, paratë barteshin edhe tërthorazi nëpërmjet emigrantëve-korrierë, që vinin në krahinën e Kosovës - Metohisë".⁷

Që edhe në ShBA shqiptarët mund të bëjnë ligjin kriminal, këtë kanë guximin ta thonë vetëm serbët dhe Dick Marty. Unë kam qenë në ShBA në vitin 1996 dhe mund të them se edhe për dy pistoleta lodër prej kauçuku si të kaubojsve të hershëm, që i kisha blerë për dy djemtë që t'i sillja si dhuratë, më kanë detyruar të hapë bagazhet e t'i kontrollojnë. Ndërsa serbët mund ta kenë provuar se si kalohen armë nga ShBA-të, por mos ta tregojnë si barsoletë për shqiptarët, le ta tregojnë si provë të bërë prej tyre. Por nuk besoj se do të kenë sukses, ndërsa si barsoletë - akuzë shpifëse për shqiptarët është fare lehtë të deklarohet. (Vijon)

¹ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 32, botimi serbisht

² Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 32, botimi serbisht

³ Po aty faqe 32

⁴ Po aty faqe 32

⁵ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 32, botimi serbisht

⁶ Po aty, faqe 32

⁷ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 32, botimi serbisht

Macroni viziton Bejrutin pas shpërthimit, bën thirrje për reforma

BEJRUT, 6 GUSHT - Presidenti francez Emmanuel Macron ka arritur të enjten në Bejrut, pas shpërthimit të 4 gushtit që ka lënë të vdekur qindra persona dhe ka plagosur mijëra të tjerë. Ai ka thënë se Libani "do të vazhdojë të zhytet" nëse nuk kryen reforma kundër korrupsionit. Vizita e Macronit ka ardhur pasi Ministria e Shëndetësisë së Libanit ka njoftuar se numri i personave të vdekur si pasojë e shpërthimit ka arritur në 137, përderisa besohet që të paktën 5 000 persona janë plagosur. Hetuesit kanë thënë më 6 gusht se janë duke kryer kërkime për shkakun e shpërthimit në portin e qytetit. Franca ka synuar për kohë të gjatë ta mbështesë ish-koloninë e saj derisa tani është në krye të mobilizimit kombëtar për Libanin. Megjithatë, zyrtarët francezë janë të shqetësuar për nivelin e korrupsionit endemik në këtë

vend, andaj kanë bërë thirrje për reforma rrënjësore në këtë shtet të Lindjes së Mesme. Macroni u ka thënë disa libanezëve të zemëruar në Bejrut se ndihma e Francës nuk do të përfundojë "në duart e korruptuar". Ai ka thënë se do ta synojë arritjen e një marrëveshjeje të re me liderët politikë të Libanit. "Do të bisedoj me forcat politike dhe do t'ju kërkoj një marrëveshje të re. Unë jam sot këtu për të propozuar një pakt të ri për ata", ka thënë ai, ndërkohë që turma e njerëzve ka bërë thirrje për një "regjim" të ri. Zyrtarët kanë thënë se një sasi e madhe e nitrarit të amonit ka nxitur incidentin, lëndë që përdoret për plehra dhe ka kapacitet shpërthyes. Sipas tyre, kjo sasi është mbajtur në kushte jo të mira për kohë të gjatë. Gjatë ditës së mërkurë qeveria ka urdhëruar që zyrtarët e portit të vendosen në arrest shtëpiak. Ministri i Brendshëm libanez,



Mohammed Fahmi, ka thënë se në portin e këtij qyteti besohet se kanë qenë më shumë se 2 700 tonë të nitrarit të amonit. Ndërsa presidentja e Komisionit

Evropian (KE), Ursula von der Leyen, gjatë ditës së sotme ka folur me kryeministrin e Libanit, Hassan Diab. Ajo i ka shprehur ngushëllime për

katastrofën që ka ndodhur në Bejrut, duke bërë me dije se KE-ja do të ndajë 33 milionë euro për nevojat e para emergjente të Libanit.

Bideni do ta pranojë virtualisht nominimin për president



WASHINGTON, 6 GUSHT - Joe Biden ka anuluar planet për pranim të nominimit presidencial nga ana e demokratëve në Milluaki më vonë gjatë këtij muaji për shkak të shqetësimeve rreth koronavirusit. Fushata e Bidenit ka thënë më 5 gusht se ish-nënpresidenti amerikan do ta realizojë fjalimin e tij të pranimit të nominimit nga shtëpia e tij në Delauer. Ky njoftim e kthen konventën e demokratëve, që do të mbahet nga 17 deri më 30 gusht, në organizim virtual. Shumica e demokratëve do të mbajnë fjalime në këtë konventë, po ashtu, në formë virtuale, derisa vetëm

zyrtarët e Viskonsin do të mund të mbajnë fjalime në qendrën në Milluaki. Konventat e partive janë ngjarje të rëndësishme në politikën amerikane, pasi aty delegatët edhe formalisht nominojnë kandidatin presidencial të partisë për zgjedhjet e 3 nëntorit. Ato, po ashtu, shfrytëzohen nga kandidatët për të qenë më afër me milionë votues. Demokratët janë duke synuar të shpërfaqin një qasje më serioze ndaj krizës publike shëndetësore, për dallim nga ajo që e konsiderojnë si qasje të rrezikshme të presidentit amerikan, Donald Trump, ndaj

pandemisë me koronavirus. Më 5 gusht, edhe Trumpi ka thënë se është duke shqyrtuar mundësinë që më 27 gusht, fjalimin për pranim të nominimit nga ana e republikanëve ta bëjë nga Shtëpia e Bardhë, ndonëse ka dilema nëse një gjë e tillë do t'i shkelte normat etike Trumpi pati bartur konventën në Florida për shkak të rregullave për distancim fizik në Karolinën Veriore, ku ishte planifikuar të mbahej fillimisht konventa e republikanëve. Mirëpo Trumpi ka anuluar më vonë edhe këto plane meqë numri i të infektuarve me koronavirus është rritur tejet shumë në Florida.

Andrzej Duda bën betimin e dytë si president polak

VARSHAVË, 6 GUSHT - Presidenti polak Andrzej Duda është betuar të enjten për mandatin e dytë pesëvjeçar. Shumica e ligjvënësve opozitarë si dhe ish-presidentë apo ish-kryeministra të Polonisë kanë bojkotuar ceremoninë parlamentare. Disa ligjvënës opozitarë që kanë qenë pjesë e ngjarjes kanë veshur ngjyra të flamurit të komunitetit, LGBT (homoseksual, lesbike, biseksual dhe transgjinnor), në shenjë proteste ndaj Dudas. Përgjatë fushatës zgjedhore,

Duda është kritikuar ashpër për qasjen e tij kundër këtij komuniteti. Opozita ka kritikuar atë që e sheh si mosrespektim të Kushtetutës nga ana e Dudas gjatë mandatit të tij presidencial. Pjesëtarët e opozitës kanë ngritur shqetësime edhe rreth pranimit të politikave të presidentit polak nga ana e partisë populiste të krahut të djathtë, Ligji dhe Drejtësia, e cila e ka përballur Poloninë dhe Bashkimin Evropian me mospajtime në disa çështje. Duda ka qenë i



afër me këtë parti, deputetët e së cilës kanë përkrahur dhe duartrokatur për të gjatë

ceremonisë së betimit në Varshavë. Duda ka thënë se është i gatshëm për të

bashkëpunuar me të gjitha grupet dhe partitë politike. Mirëpo ai, po ashtu, ka theksuar nevojën për mbrojtje të rolit të familjes në shoqërinë polake. Këto komente janë parë nga kritikët si përsëritje e retorikës së tij gjatë fushatës, e cila me raste ka qenë armiqësore ndaj të drejtave të komunitetit, LGBT. Duda ka fituar 51 për qind të votave në zgjedhjet e 12 korrikut, në garën kundër kryetarit të Varshavës, Rafal Trzaskowski në një proces ku kanë marrë pjesë 65 për qind e popullsisë.



Eduardo Galeano: Pse shkruaj

Dua të flas pak për si dhe pse u bëra shkrimtar

Në fillim një pohim: Qysh femijë, jam përpjekur të bëhem futbollist. Jam ende numri një. Më i miri nga më të mirët, por vetëm gjatë gjumit, ndërsa fle, sepse porsa zgjohem, pohoj që kam këmbë prej druri dhe s'kam asnjë mundësi tjetër përveçse të përpiqem të jem shkrimtar.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të them më shumë me më pak, duke kërkuar fjalë që janë më të mira dhe më të mençura se heshtja, fjalë të zhveshura nga retorika. Shkrimi ka qenë, dhe ende është, mjaft i vështirë, por shpesh më bën të përjetoj ndjenja të thella dhe kënaqësi të madhe, larg vetmisë dhe harresës.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të jem i aftë të mësoj si të fluturoj në errësirë, të vjell gënjeshtër që jemi të detyruar të gëlltisim çdo ditë, dhe të jem i pabindur kur zotërit e botës japin urdhëra që i kundërvihen ndërgjegjes time dhe gjykimi të shëndoshë.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të mendoj se s'mund të jem asnjëherë, dhe s' mund të

jem objektiv sepse nuk dua të bëhem objekt, shpërfillës ndaj pasioneve njerëzore.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të denoncoj atë proverbin e vjetër që thotë se Njeriu është ujku i Njeriut. Gënjeshër.

Ujqërit nuk vrasin kurrë ujqer, dhe ne jemi kafshët e vetme që specializohen në shfarosjen e ndërsjelltë.


Kam bërë, bëj gjithçka mundem, të shkruaj për zbulimin e grave dhe burrave që kanë vullnet për drejtësi dhe për të bukurën, ata janë bashkëatdhetarët dhe bashkëkohësit e mi, pavarësisht se ku u lindën apo kur jetuan, përtej kufijve të kohës.

Kam bërë, bëj gjithçka mundem, të jem aq kokëfortë sa të vazhdoj të besoj, pavarësisht të gjitha dëshmimeve se ne njerëzit jemi krijuar keq, sepse jemi ende të papërfunduar.

Kam bërë gjithçka mundem, dhe shpresoj se do të përpiqem gjithmonë, të zgjedh anën e duhur, e cila ndodh të jetë në luftën e përvetshme të zemëratës kundër zemëratës.

Kam bërë, bëj gjithçka mun-

dem. Ia vlen, më besoni. Ne mund ta ndryshojmë atë fjali të famshme të shkruar nga shoku im, Billi...Bill Shekspiri: "Jeta është përrallë e rrëfyer prej një të marrë, plot bujë dhe tërbim, pa kurrfarë kuptimi!"



Pse u bëra shkrimtar

Dua t'ju tregoj historinë e sfidësime të parë të vërtetë si rrëfimtari, herën e parë kur pata frikë

se mos ndoshta nuk isha në lartësinë e detyrës. Ndodhi në qytetin bolivian të Llallagua-s. Kalova ca kohë atje, afër minierës. Ishte vendi ku ndodhi masakra e San Juanit, kur diktatori Barrientos urdhëroi trupat të hapnin zjarr nga lartësitë e kodrave përreth, ndaj minatorëve që ishin duke pirë dhe vallëzuar në vigjilje të Shën Gjonit.

Mbërrita rreth një vit më vonë, në vitin 1968-të, dhe qëndrova për ca kohë falë aftësive të mia si artist. Gjithmonë kisha ndjerë një nxitje për të vizatuar, megjithëse skicat e mia kurrë nuk arritën të mbyllnin hendekun midis vetes dhe botës.

Humnera më e madhe ishte midis aftësive dhe synimeve të mia, megjithëse disa nga portretet e mia dolën mirë dhe isha i mirë në vizatimin e gërmave. Në Llallagua vizatova portrete të fëmijëve të minatorëve dhe pikturova postera për karnavale, për ngjarje publike, çfarëdo gjëje që duhej. Kështu që qyteti më birësoi, dhe kalova shumë mirë në atë botë të mjerë, të ngrirë, ku të ftohtit e bën më të ashpër varfërinë.

Nata e largimit tim mbërriti.


Minatorët ishin miqtë e mi dhe më organizuan një festë lamtumire me shumë pije. Rrëkëllyem *chicha* dhe *singani*, një lloj grape e shijshme por disi e padurueshme. Po festonim, këndonim, bënim shaka, dhe gjatë gjithë kohës e dija që në orën pesë ose gjashtë të mëngjesit, sirena do të shpërthente, duke i thirrur ata të nisnin punën në minierë, dhe do të mbaronte gjithçka. Do të ndaheshim.

Kur u afraua çasti, më rrethuan sikur po më akuzonin për diçka. S'po më akuzonin për asgjë, por më thanë: -Tani, na trego për detin.

Mbeta pa fjalë. Minatorët u dënuan me një vdekje të hershme nga silikoza në thellësi të tokës. Në ato kohë jetëgjatësia në pusët e minierës ishte 30 ose 35, jo më shumë. Ata kurrë nuk do ta shihnin detin, do të vdisnin pa asnjë mundësi për t'i hedhur sytë nga ai, ishin paracaktuar të mbeteshin në qytezën e mjerë të Llallagua-s. Detyra ime ishte ta sillja detin tek ata dhe të gjeja fjalë e duhura që të zhyteshin në të.

Kjo ishte prova ime e parë si rrëfimtari dhe më bindi që përballja me të ia vleme.

/Exlibris.al/ Përktheu:
Granit Zela



E vërteta për Epirin e lashtë

Nga: **Kristo FRASHËRI**

Gjurmët më të hershme arkeologjike të jetës njerëzore në truallin e sotëm të Greqisë dhe Shqipërisë të zbuluara deri tani na çojnë në fundin e Paleolitit të mesëm, më saktë në fundin e të ashtuquajturës periudhë musteriiane. Në historiografinë botërore mbisundon pikëpamja se për mijëra vjet me radhë banorët e kësaj periudhe qenë fise baritore shtegtare, të cilat lëviznin në kërkim të kullotave për tufat e tyre. Edhe gjatë Paleolitit të vonë, në këto treva vazhduan të banonin fise baritore shtegtare. Përderisa ishin fise shtegtare, për përkatësinë e tyre etnike as që mund të bëhet fjalë.

Puna ndryshoi në periudhën e Neolitit, kur fiset shtegtare në sajë të bujqësisë u shndërruan në popullata sedentare, pavarësisht se krahas tyre vazhduan të ekzistonin fise shtegtare stinore. Në fund të periudhës së Neolitit, kur shoqëria njerëzore arriti pjekurinë e saj, fillon afërsisht 6000 vjet më parë edhe historia e qytetërimit në trevën e Epirit. Se cilët qenë këta banorë të hershëm të Epirit, çfarë gjuhe flisnin dhe cila ishte përkatësia e tyre etnike vështirë të thuhet. Ata duket se bënë pjesë në grupin e madh të popullatave, të cilat në mijëvjeçarin e fundit të Neolitit banonin në brigjet veriore të detit Mesdhe.

Shumë historianë, gjuhëtarë, etnologë dhe antropologë mendojnë se popullatat që banonin në periudhën e fundit të Neolitit gjatë brigjeve veriore të detit Mesdhe bënë pjesë në popullatat e grupit etnogjuhësor mesdhetar. Nga tradita historike dihen dhe disa emra fimesh apo popullatash të kësaj epoke, si: lelegë, karianë, iberë, tirenë, oskë,

umbrë, etj. Gjurmët e qytetërimit mesdhetar në truallin e Shqipërisë së sotme janë zbuluar në truallin e liqenit të dikurshëm të Maliqit. Se cilat nga këto popullata të grupit etnogjuhësor mesdhetar banonin në viset e sotme të Shqipërisë dhe të Epirit, përsëri është vështirë të thuhet. Rreth 25 shekuj para erës sonë, kur u mbyll epoka e Neolitit dhe nisi epoka e metaleve, rrjedha e jetës njerëzore në mbarë pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik përfshirë dhe trevën epirote, pësoi ndryshim. Faktori që shkaktoi këtë ndryshim qe dyndja në këtë trevë e popullatave të grupit etnogjuhësor indoevropian, të cilat për disa historianë erdhën nga deti, për disa të tjerë nga toka. Mendohet se vatra fillestare e popullatave indoevropiane ka qenë në Rusinë e sotme jugore, në trevën midis Detit të Zi dhe Detit Kaspik. Nga kjo trevë filloi shtegtimi grupe-grupe dhe kohë pas kohe i popullatave të sotme të familjes etnogjuhësore indoevropiane. Të parët që u shkëputën nga vatra e tyre fillestare duket se qenë hititët, të cilët morën drejtimin e Jugut dhe u vendosën në Azinë e Vogël, në afërsi të qytetërimit mesopotam. Më vonë, qenë helenët të cilët shtegjuan drejt Perëndimit dhe u vendosën në pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik në afërsi të qytetërimit egjean.

Këta indoevropianë të parë që u vendosën në rajonin e Evropës Juglindore, ku bënë pjesë edhe Epiri, për t'u dalluar nga grupet e tjera që shtegjuan më vonë (helenët, trakët, ilirët), është bërë zakoni të quhen protoindoevropianë, në kuptimin e indoevropianëve të hershëm. Sipas njoftimeve që na japin historianët, gjeografët dhe shkrimtarët e vjetër grekë, popullatat e lashta që banonin

në këto vise para shtegimit të helenëve, qenë "pellazgët", të cilët më vonë u asimiluan nga popullatat e reja indoevropiane. Këtu indoevropianët bashkëjetuan për shekuj me radhë me popullatat e grupit etnogjuhësor mesdhetar, kurse më vonë të dytët u asimiluan nga të parët. Vendosja e indoevropianëve në Epir vërtetohet ndër të tjera nga shfaqja e një riti të ri varrimi, që ka dalë prej kohësh në dritë gjatë zbulimeve arkeologjike. Janë varret tumulare ose siç quhen ndryshe varret kurgane, të zbuluara kryesisht në pjesën jug-perëndimore dhe perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Banorët e rinj indoevropianë të vdekurit i shtrinin në tokë pa hapur gropë dhe pastaj i mbulonin me dhe Kur pjesëtarët e tjerë të familjes patriarkale vdisnin, trupat e tyre vendoseshin mbi tumulin e paraardhësit të tyre. Kështu veprohej edhe për brezat pasardhës. Me kohë, varreza e një bashkësie ose e një familjeje të madhe patriarkale kthehej në një kodër, latinisht tumulus, rusisht kurgan, shqip tumë.

Në fillim të mijëvjeçarit II p.e.s., pra në fillim të epokës së Bronzit, pjesa jugore e Gadishullit Ballkanik pësoi një valë të re dyndjesh popullatash indoevropiane. Dëshmi për këtë dyndje është fakti se popullatat e reja nuk përdornin varrezat tumulare, por praktikonin varrosjen e të vdekurit në gropë. Këto qenë popullatat helene, të cilat u shtrinë në viset kontinentale dhe ishullore të banuara më parë nga pellazgët. Nga ishujt e Egjeut kaluan edhe në Azinë e Vogël. Më vonë, afërsisht në mesin e Epokës së Bronzit në Gadishullin Ballkanik u dukën protoilirët, kurse në fund të epokës së Bronzit ilirët e historisë, të cilët zunë vend në veri të Helladës dhe

në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik.

Helenët bashkëjetuan për shekuj me pellazgët, morën prej tyre elementë të qytetërimit pellazgjik derisa i asimiluan, ashtu si pellazgët kishin asimiluar nga ana e tyre popullatat e mëparshme mesdhetare. Asimilimi nënkupton huazime elementësh kulturorë, por jo identifikim etnik. Dihet se nga përplasje e dy identiteteve njëra prej tyre zhduket.

Për këtë arsye, grekët nuk qenë si etni identikë me pellazgët, por pasardhësit fizikë të tyre. Si rrjedhim, konkluzioni i historianëve të Greqisë moderne se helenët antikë ishin si etni pasardhësit gjenetikë të pellazgëve, nuk qëndron. Këtë teori e kanë kundërshtuar jo pak historianë të shkollave të ndryshme historiografike botërore.

Me teorinë nacionaliste helene nuk janë pajtuar as historianët shqiptarë. Ajo që ndodhi midis grekëve dhe pellazgëve u përsërit edhe midis ilirëve dhe pellazgëve. Edhe ilirët trashëguan jo pak elemente të qytetërimit pellazgjik. Megjithatë, as ilirët nuk mund të konsiderohen pasardhës gjenetikë të pellazgëve. Sipas tyre, helenët dhe ilirët e kohës antike, paraardhësit e grekëve dhe shqiptarëve të ditëve tona, i asimiluan pellazgët, pa e humbur identitetin e tyre të veçantë etnik dhe gjuhësor ilir. Çështjen se cila popullatë mbisundonte në Epir në fillim të mijëvjeçarit të parë p.e.s., – helenët apo ilirët – e ndriçojnë materialet arkeologjike, të pasuara nga burimet e shkruara historike. Kjo çështje përbën thelbin e kapitujve të parë të monografisë së përmendur me pretendime shkencore mbi "qytetërimin 4000 vjeçar grek të Epirit", botuar nga Akademia e

Athinës më 1997. Monografia ka, përta i përket historisë antike të Epirit, një veçori të cilën nuk e kemi ndeshur më parë. Historianët grekë, kurdoherë krenarë për të kaluarën e tyre të lashtë, kanë preferuar që historinë e tyre "zyrtare" ta shkruajnë ata vetë. Kjo sepse, sipas tyre, historianët jo grekë nuk janë në gjendje ta kuptojnë dhe ta realizojnë këndvështrimin se thelbi i historisë së Greqisë nuk është historia e grekëve, por e helenizmit. Këtë radhë, sipas tyre, puna ndryshon. Historinë e helenizmit parahistorik, protohistorik dhe klasik në monografinë e përmendur akademike e ka shkruar një historian britanik – Nicholas G.L.Hammond, në atë kohë profesor në Universitetin e Bristolit, në Britaninë e Madhe dhe njëkohësisht profesor honorar në Universitetin e Janinës (Greqi). Vetëm pasi i lexon kapitujt të cilët trajtojnë qytetërimin helenik në Epir, mëson arsyen përse kolektivi i historianëve grekë ka preferuar t'ia besojë profesorit britanik pjesën e parë të vëllimit. Nga mënyra se si ai e ka trajtuar historinë e lashtë të Epirit, N.G.L. Hamondi ua ka tejkaluar grekëve në vlerësimin apologetik të helenizmit në Epir.

Ne e kemi njohur nga afër Hammondin gjatë vizitës që ai bëri në Shqipëri më 1972. Nuk e patëm të vështirë të bindeshim se ai nuk e fshihte mospërfilljen ndaj historisë shqiptare të së kaluarës dhe të së tashmes. Ai kërkonte me ngulm të gjente me çdo kusht çdo thërmijë të kulturës greke në Shqipëri dhe nuk pranonte të merrte në konsideratë asnjë gjurmë kulturore ilire, edhe kur këto objekte qenë me shumicë. Kur ne i sugjeruam të shihte objektet ilire të ekspozuara në muzetë tona, ai përgjigjej:

"Nuk më interesojnë objektet ilire, më interesojnë vetëm gjurmët helene". Edhe pyetjes sonë se si mund të mbivlerësohet një gjurmë e veçuar greke në morinë e objekteve ilire, të zbuluara në të njëjtin vend, ai përsëri i përgjigjet: "Unë nuk merrem me objektet ilire, unë merrem vetëm me kulturën greke". Kjo mospërfillje ndaj kulturës ilire dhe mbivlerësimi i thërrmijave kulturore greke në viset ilire bie në sy gjatë gjithë paragrafëve që kanë dalë nga pena e tij.

Ai nuk i trajton pellazgët si një kombësi më vete. Duke mbivlerësuar disa huazime kulturore pellazge në traditën greke, ai nxjerr konkluzionin e habitshëm se helenët nuk kanë shtegtuar në Ballkan në fillim të epokës së Bronzit, as pesë shekuj më parë kur shtegtuat protoindoevropianët e hershëm, por janë pjellë e historisë së truallit grek. Pra, sipas tij, helenët kanë qenë vazhdimisht në truallin ballkanik dhe se epiteti që Homeri u jep pellazgëve si popullatë hyjnore u takon pa mëdyshje helenëve. Këtë hamendësim N. Hammondi e shtrin edhe kur flet për Epirin. Ai nuk i mhton njoftimet që përmban letërsia klasike mbi praninë e pellazgëve në Epir. Por, nga ky hamendësim, Hammondi nxjerr konkluzionin se helenët kanë qenë në Epir që kur shfaqen varret tumulare, pra që kur vërtetohet prania e pellazgëve në trevën epirote.

Pavarësisht se ka dijetarë që nuk e pranojnë se pellazgët qenë bartësit e kulturës tumulare – tashmë apelativ i pellazgëve përdoret në mënyrë konvencionale si emri i protoindoevropianëve të hershëm, të cilët banonin në Gadishullin Ballkanik para grekëve dhe para ilirëve. Ndër historianët dhe gjeografët e vjetër grekë dhe romakë, të cilët pohojnë se banorët më të hershëm të Epirit qenë pellazgët, Plutarku (shekulli II), thotë se pellazgët e hershëm që banonin në Epir quheshin thesalë. Sipas tij, pellazgët në Epir erdhën fill pas ndodhi përmbytja mitologjike e Noes e cila, sipas Biblës, ka ndodhur në kohët parahistorike. [1] Plutarku njofton gjithashtu se një nga veprat e pellazgëve të hershëm kur ata erdhën në Epir, ishte ndërtimi i faltores së Dodonës, një nga faltoret më të famshme të kohës antike, gërmadhat e së cilës janë zbuluar 18 km në jug të Janinës.

Themelimin nga pellazgët të faltores së Dodonës në trevën e Epirit e përmend për të parën herë poeti epik grek, Homeri. Ai thotë për të:

O Zeus, mbret dodonas e pellazgjik, që banon larg/ që kujdesesh për Dodonën me dimër të ashpër/ ku për rreth janë selët/ aty banojnë fallxhorët që nuk lajnë këmbët e flenë për tokë. [2] Straboni, gjeografi grek i shekullit I, i cili ka njoftime për Epirin më të pasura se çdo autor tjetër antik, shkruan: "Shumë autorë të

vjetër edhe fiset epirote i kanë quajtur pellazgjike, sepse ata (pellazgët – K.F.) shtriheshin deri në Epir". [3]

Straboni shkruan gjithashtu: "Orakulli i Dodonës, sipas Eforit, është ndërtuar nga pellazgët. Për pellazgët flitet se kanë qenë më të vjetrit nga të gjithë ata popuj që kanë sunduar në Helladë. Hesiodi thotë se Dodona dhe Lisi ishin qendra e pellazgëve". Straboni shton më në fund se popullsitë që banonin rreth e rrotull Dodonës qenë barbarë, pra jo grekë. Nga Straboni del se Dodona ishte ndërtuar në një truall të banuar nga pellazgët, pra jo nga grekët dhe se më vonë u përfshi në kufijtë e Molosisë, pastaj të Thesprotisë – dy fiset kryesore të Epirit, të cilët sikurse do të shihet më tej, ishin me përkatësi etnike ilire. Këtë e përforon edhe Skimni [4] i cili shkruan: Në Molosi "është edhe Dodona/ faltore e Zeusit, themeluar prej pellazgëve / Në viset e brendshme banojnë barbarë të përzier / për të cilët shtojnë se banojnë pranë faltores". Herodoti, historiani i parë i Greqisë së vjetër (shekulli V p.e.s.), shkruan se në fillim pellazgët adhuronin perënditë e tyre, por nuk i njihnin me emra. Kur panë se në Egjipt perënditë kishin emra të veçantë, vendosën që edhe ata t'i pagëzonin perënditë e tyre me emra të veçantë. Para se të vendosnin, erdhën në Dodonë dhe pyetën orakullin, i cili u përgjigj se mund t'i quanin perënditë me emra të veçantë. Gjithnjë sipas Herodotit, më vonë helenët i morën nga pellazgët emrat e perëndive.

Nga njoftimet që japin autorët e vjetër grekë dalin këto konkluzione: se asnjë autor antik grek nuk pohon se banorët e Epirit të lashtë qenë grekë; përkundrazi, të gjithë janë dakord se qenë pellazgë; se pellazgët dhe grekët përfaqësojnë jo një, por dy kombësi të ndryshme; e treta, se qendra kryesore shpirtërore e pellazgëve, faltarja e Dodonës, ndodhej në zemrën e trevës epirote; se banorët e trevës së faltores së Dodonës qenë "barbarë", pra jo grekë; se praktikën e pagëzimit të perëndive me emra të veçantë grekët e morën nga pellazgët. Shkurt, pellazgët banonin në Epir para se të shfaqeshin në Ballkan helenët dhe ilirët.

Megjithëse historikisht nuk vërtetohet prania e helenëve në Epir që nga kohët parahistorike, historianët grekë janë gozhdur prej kohësh pas pikëpamjes se grekët kanë banuar në këto vise që në agimin e historisë.

Ndër historianët grekë të Paraluftës zgjodhëm K. Gjerojanin, mbasi trajtesa e tij përfaqëson në mënyrë koncize, më mirë se të tjerat, vizionin që kishte historiografia greke mbi Epirin antik në periudhën midis dy luftave botërore. Ai ngul këmbë se faltarja e Dodonës është gjithsesi greke, me argumentin e përciptë se grekët



Pikturë e francezit Nicolas René Jollain, "Fëmija Pirro para Glaukut" (1791). Pirroja legjendar i Epirit, është rritur nga mbreti ilir i taulantëve, Glauku, dhe gruaja e tij Beroea e Epirit (nga fisi i molosëve), të cilët nuk ia dorëzuan atë mbretit maqedon Kasandrit që merr kontrollin ndaj Epirit. Pirro është një nga luftëtarët më të famshëm të antikitetit, emri i të cilit do të përvetësohet nga grekët. Në një letër të 31 tetorit 1460, Heroi Kombëtar shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, rivalit të Ferdinandit të Napolit, princit të Tarantit, i thotë se shqiptarët nuk i tradhetojnë miqtë dhe se shqiptarët e kanë prejardhjen nga Pirro i Epirit. "Në qoftë se kronikat tona nuk gënjejnë, ne quhemi epirotë. Duhet ta dini se në kohë të tjera, paraardhësit tanë kaluan në vendin që ju mbani sot dhe patën bërë luftime të mëdha me romakët dhe, nga sa dimë, në të shumtën e herës u ndanë me nder sesa me turp", thuhet ndër të tjera në atë letër.

qenë pasardhësit e pellazgëve. Si rrjedhim, praninë e pellazgëve ai e identifikon pa të drejtë me praninë e grekëve në Epir. Siç dihet, identifikimi i pellazgëve me helenët ka qenë një tezë romantike e historianëve grekë të kohëve të reja, tezë të cilën sipas mendimit të përgjithshëm, koha e ka marrë me vete.

Edhe orvatja e K. Gjerojanit për ta lidhur emrin "Hylloi" të banorëve të trevës së Dodonës me emrin "helenë", është e nxituar. Sipas dijetarëve të linguitikës historike, kjo lidhje është artificiale. Përkundrazi, ata shohin te emri "Hylloi" – te Skilaksi [5]; "Hyllis" te Plini Sekundi; [6] te Eustathi [7] – një apelativ ilir që ka në rrënjë fjalën "yll", i cili nga ana e vet ka lidhje gjithashtu me fjalën shqipe "hyjni" (perëndi). Shkurt, pohimi i K. Gjerojanit se "epirotët kanë qenë gjithmonë dhe nuk pushuan asnjëherë së qeni grekë" [8] është një deklaratë retorike e cila, nuk ka mbështetje as logjike, as dokumentare.

Edhe Hamondi, për fat të keq, në punimin e përmendur, shkel në truallin e hamendësimeve. Sipas tij, e folmja e popullatave protoindoevropiane që mbuluan Epirin në fund të mijëvjeçarit III p.e.s. ose në fillim të mijëvjeçarit II p.e.s. mund të ishte as ilirishtja, aq edhe greqishtja. Konkluzion ky, hëpërhë, pjesërisht i drejtë. Por ai, pa patur ndonjë argument që ta bindë sadopak lexuesin, shton se në veriun e largët krerët kurganë flisnin një formë të hershme të ilirishtes, kurse në Epir, thekson ai, gjuha e tyre ishte "ndoshta" greqishtja. Pra, sipas tij, kemi të bëjmë me një kombësi me dy gjuhë. Ne nuk dimë se ku e mbështet ai këtë kon-

kluzion, veçse na duket e çuditshme që e njëjta kombësi, protoindoevropianët, të kishin, në mijëvjeçarin III p.e.s., dy gjuhë – në veri ilirishten dhe në Epir greqishten (sic!). Megjithatë, më poshtë Hamondi e thotë prerazi se në bazë të varrezave tumulare të Helladikut të Mesëm (1900-1600 vjet p.e.s.), të zbuluara në disa vise të Greqisë së sotme qendrore dhe në disa pika të ndryshme të Peloponezitet, del se vetëm krerët kurganë (sic!) qenë greqishtfolës dhe jo shtresat e gjera të popullsisë.

Sipas Hamondit, dëshmi se popullata greqishtfolëse shfaqen në Epir 2100 vjet p.e.s. janë sëpatat për luftë prej guri me vrimë, të cilat janë zbuluar edhe në stacionin e Maliqit pranë Korçës. Pra, nga një sëpatë me vrimë zbuluar në Maliq del, sipas tij, se në pellgun e Korçës në fund të mijëvjeçarit III p.e.s. popullatat ishin greqishtfolëse (sic!). Ne, gjithashtu, e kemi të vështirë të pajtohemi me bindjen që ka Hamondi se tërësia e objekteve miniane, të cilat shfaqen në Epir në fund të Helladikut të hershëm, janë prodhuar nga fiset e para greqishtfolëse, të cilat u vendosën në Epir, gjithnjë sipas tij, siç e tregojnë dëshmitë arkeologjike, paqësisht. Më tej N. Hamond thotë, pa na sjellë asnjë argument bindës, se krerët e varrezave tumulare e përhapën helenizmin nga Maqedonia në Epirin e Jugut, pastaj nga Epiri i Jugut në Epirin e Veriut, ku dihet se mbisundojnë skërkat malore. Ai nxjerr konkluzionin krejtësisht hipotetik se qysh në Helladikun e Mesëm gjuha greqishte u shtri në një trevë, në Epir, prej së cilës ajo nuk do të nxirrej më kurrë. [9]

Nuk kuptohet, se si popullatat kurgane qenkan përhapur nga jugu në veri, kur dihet se tipari kryesor i shtegtimeve të popullsisë gjatë Parahistorisë, Protohistorisë dhe Antikitetit ka qenë, të paktën përse i përket Gadishullit Ballkanik, nga veriu drejt jugut, pra, drejt Egjeut. Kjo për arsye se Egjeu ka shërbyer si pol magnetik për hir të ujërave të tij të ngrohta, por ca më tepër për epërsinë e tij kulturore.

Duke mos u marrë më tej me pohimet joshkencore të historianëve nacionalistë grekë dhe të miqve të tyre evropianë, ne mendojmë se në fund të epokës së Bronzit në Epir banonin popullatat protoindoevropiane, të cilat nuk i përkisnin as etnisë helene, as etnisë ilire, por botës pellazge. Këtë vizion historik kemi edhe për Çamërinë e lashtë protohistorike, banorët e së cilës nuk i përkisnin as etnikonit helen, as atij ilir, por banorëve pellazgë. /Fondacioni "Henrietta Leavitt"/

[1] Plutarku, *Pyrrhus*, 1,1.

[2] Homeri, *Iliada*, XVI 233 e 234.

[3] Straboni, *Libri V. 2,4*.

[4] Skimni, V, 448.

[5] Skilaksi, 220

[6] Plini Sekundi, 3, 22

[7] Eustathi, 384

[8] E , M.E.E. vol. XII, f. 326.

[9] *Epirus 4000 years of greek history and civilization* (Epiri 4000 vjet histori dhe qytetërim grek), General editor, M. B. Sakellariou, Athens 1997. *Many of them may have joined in the southwards movement which was to establish what we call Mycenaean civilization and to introduce the Greek language into an area from which it was never to be ousted*, f. 36.

/Telegrafi/

E rrallë

Hapet bari i parë i bitcoin në Evropë



Është hapur bari i parë i bitcoinit në Evropë ku të ftuarit, përveçse do të pinë kafe, do të mësojnë edhe rreth kriptovalutave. Ky bari është hapur në qendër të Romës. Në këtë objekt hotelier do të jetë e mundur të informoheni për monedhat, të cilat, sipas mediave italiane, janë gjithashtu të mundshme për pagesa, si dhe regjistrimin në platformë, blerje dhe tregti. Bari i bitcoinit, një vend takimi për njerëzit e interesuar për kriptovaluta, është hapur pranë 'Piazza Barberini' në kryeqytetin italian.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: Pse po gënjen, ti ishe duke shkuar 70 km/h!
Burri: Ti mos fol!
Polici: Po ju nuk e keni vënë as rripin e sigurisë.
Burri: E hoqa tani, pasi më ndaluat ju.
Gruaja: Prapë po gënjen!
Burri: Mbylle gojën.
Polici: Gjithmonë flet ky me ju kështu?
Gruaja: Jo, vetëm kur është i dehur.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



FOTO E DITES



Pamje nga përendemi i diellit në Ksamil, Shqipëri. /LSA/

E rrallë

Surprizat nga shkrija e akullnajave

Disa ekspertë kanë zbuluar mbetjet e një gjallesë të gjatë rreth 10 metra që mendohet të jetë një Mamuth, ku kishte copa të indeve të buta dhe në kockat e tij ishin të bashkëngjitur edhe lëkura. Zbulimi u bë në një liqen të Siberisë ku, sipas ekspertëve, gjallesa mendohet të ketë vdekur 10 mijë vjet më parë. Mamuthi mendohet të ketë qenë rreth 15-20 vjeç. Ekspertët nga Qendra Shkencore për Studimet e Arktikut janë duke punuar për t'i studiuar mbetjet e gjallesës 10 mijë vjeçare që u gjet nën llumin e liqenit. Zbulimi i gjallesës gjigante vjen si pasojë e shkrijës ekstreme të akujve gjatë viteve të fundit në Arktikun Siberian, që ka zbuluar krijesat e fshehura që nga kohët e lashta. Ekspertët po përpiqen ta marrin ADN-në e mjaftueshme të mamuthëve, që janë zhdukur prej Epokës së Akullit, në mënyrë që t'i rikthejnë përsëri ata nëpërmjet një prove që do eksperimentojnë. Ata mendojnë se në sipërfaqen e liqenit mund të jetë një varrezë e madhe e mamuthëve dhe kafshëve të tjera që mund të gjenden aty, por kushtet aktuale e bëjnë të vështirë nxjerrjen e skeleteve. Mamuthët e kanë shkelur planetin gjatë Epokës së Akullit. Gjurmët e tyre të fundit u zhdukën rreth 4 000 vjet më parë në ishujt Artik rusë.

 <p>DASHI Është koha për të menduar për veten tuaj. Një ndjenjë e brendshme sot, do ju tregojë nëse duhet të vazhdoni rrugën që keni nisur apo ta ndërprisni atë.</p>	 <p>DEMI Yjet ju nxisin që të shprehni dëshirat tuaja sado intime të jenë, me një qëndrim të vendosur dhe të sigurt edhe nëse jeni në një lidhje dashurie.</p>	 <p>BINJAKËT Është periudha perfekte për forcimin e marrëdhënieve ndërrjerëzore, si dhe për sqarimin e çdo keqkuptimi me partnerët dhe miqtë sentimental.</p>	 <p>GAFORRJA Ditë e shkëlqyeshme për ju sot, nuk do ketë asnjë hije në qiellin tuaj. Kjo është arsyeja pse ju jeni një shok i shkëlqyer për të udhëtuar, për të bërë pushime dhe aktivitete të ndryshme.</p>	 <p>LUANI Është dita e duhur për të ndryshuar stilin e jetës tuaj, nëse ajo aktuale nuk ju pëlqen. Nëse jeni në punë do keni një ditë që do jua lehtësojë realizimin e projekteve.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Yjet e ju ofrojnë një dozë shtesë entuziazmi që ju vjen nga vetëdija. përvoja aktuale e jetës po ju mëson bazat në sektorë të rëndësishëm ekzistencialë.</p>
 <p>PESHORJA Krijimtaria dhe një dozë e mirë e individualitetit janë karakteristikat që ju ndihmojnë të nxirni menjëherë përfundimet e duhura, pa hezituar shumë përballë zgjedhjeve që ju paraqiten gjatë ditës.</p>	 <p>AKREPI Ngarkesa juaj sensuale i jep efikasitet më të madh propozimeve të dashurisë, intensitetit të ndjenjave që e bëjnë jetën për të dy të veçantë.</p>	 <p>SHIGJETARI Konsolidimi i lehtë i pozicioneve profesionale dhe një miqësi për të cilën ju intereson. Sigurohuni që një anëtar i familjes në vështirësi të ketë të gjithë ndihmën e nevojshme.</p>	 <p>BRICJAPI Yjet përqendrohen në marrëdhëniet shoqërore, marrëdhëniet me vëllezërit dhe motrat, mediet dhe shkrimet. Takime interesante në çdo aspekt.</p>	 <p>UJORI E enjte e përkryer për t'iu përkushtuar angazhimeve dhe interesave specifike, në veçanti atyre ekonomike. Investoni disa para, përmirësoni fitimet, kujdesuni për kredinë.</p>	 <p>PESHQIT Atraksione të dukshme priten për Peshqit beqarë të cilët do jenë të disponueshëm për kontakte. Sukseset e shkëlqyeshme në të gjitha llojet e projekteve.</p>

Armina Mevlani rrëmben vëmendjen me pozat atraktive nga plazhi



Modeluesja e njohur shqiptare Armina Mevlani është shumë e dashur për publikun. Duke qenë e tillë, ajo qëndron aktive në rrjete sociale aty ku edhe publikon imazhe të ndryshme edhe nga përditshmëria. Së fundmi, ajo ka ndarë imazhe nga plazhi teksa është duke i shijuar ditët e nxehta në bregdet. Sigurisht se komentet ishin të shumta pasi ajo dukej tejet seksi. Ndryshe Armina Mevlani është e fejuar prej vitesh me Shkëlzen Berishën dhe jetojnë së bashku në Tiranë.

Gjyqtarja shqiptare e futbollit provokon me foto të nxehta nga plazhi



Me fillimin e gushtit kanë filluar pushimet për një pjesë të mirë të njerëzve, të cilët presin ta ekspozojnë trupin në diellin përvëlues e të freskohen në ujërat e freskëta të plazheve më të bukura. Pas një sezoni të vështirë nga çdo aspekt, si futbollistët dhe

gjyqtarët kanë filluar pushimet. Ajo që ka tërhequr shumë vëmendje është asistentja e FIFA-s, Erinda Kume. Gjyqtarja e futbollit ka postuar në rrjetet sociale disa foto, ku shfaqet me bikini. Erinda duket në një formë të shkëlqyer, teksa bien në sy linjat e saj të përkryera.



Marina Vjollca tërheq vëmendjen me pamjen e re

Marina Vjollca është padyshim një ndër moderatoret më të dashura dhe më simpatike të ekranit. Së fundmi, përmes disa postimeve në "Instagram", ajo ka habitur fansat me look-un e saj të ri. Marina ka ndryshuar jo vetëm ngjyrën e flokëve, por edhe modelin. Ndryshe nga sa jemi mësuar ta shohim, Marina është shfaqur me flokë të

zinj, të shkurtër dhe balluke. Komentet kanë qenë të shumta nga ana e fansave, por i menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i bashkëshortit të saj, Ghetto Geasy dhe motrës Luana. "Më e mirë ajo që e kam, por edhe kjo nuk qenka keq", ka shkruar me humor Getoari, kurse Luana i ka komentuar: "Kush je ti dhe çfarë i ke bërë Marinës së ëmbël e të mirë".

Kim Kardashiani ende dëshiron ta shpëtojë martesën



Kim Kardashiani dëshiron ta shpëtojë martesën. Edhe pse mediat kanë shkruar se udhëtimi i saj në Cody në Wyoming, kur është filmuar duke qarë, ishte në të vërtetë lamtumira me burrin e saj dhe se me atë rast ajo kishte vendosur t'i tregojë reperit 43-vjeçar se martesë e tyre ka marrë fund. Por,

në fakt, kjo nuk duket të jetë e vërtetë. Burime pranë Kim Kardashianit dhe Kanye Westit kanë zbuluar se ata nuk kanë hequr dorë nga dashuria e tyre. "Ajo dëshiron të bëjë gjithçka që mundet për ta shpëtuar martesën e tyre, edhe pse gjithçka është mjaft e ndërlikuar", ka thënë një burim i afërt me çiftin.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina ndahet me Ibrahimin dhe Ahmetin

Fituesja e Kupës së Kosovës në Futboll, Prishtina, ka vendosur të mos i vazhdojë kontratat me Labinot Ibrahimin dhe Ergyn Ahmetin të cilët tash janë futbollistë të lirë. Klubi "bardhekaltër" u ka uruar suksese futbollistëve në fjalë për vazhdim të karrierës futbollistike



PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - FC Prishtina ka konfirmuar largimin e dy futbollistëve Labinot Ibrahimit dhe Ergyn Ahmetit, të cilëve u ka skaduar kontrata dhe tash janë futbollistë të lirë. "Mbrojtësit 34-vjeçar Labinot Ibrahimit dhe mesfushorit 24-vjeçar Ergyn Ahmetit iu kanë skaduar kontratat dhe janë futbollistë të lirë. Ibrahimin dhe Ahmetin FC Prishtina i falënderon për angazhimin maksimal dhe iu dëshiron suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas. Mbrojtësi Labinot Ibrahimit në Prishtinë ka luajtur për katër sezone e gjysmë, 2009-2013 (në pranverë 2012 ishte i huazuar) dhe edicioni i sapopërfunduar, 2019/20. Ai çka ka regjistruar 139 paraqitje zyrtare (12 zëvendësuar, 14 zëvendësues dhe ka arritur 86 fitore, 25 barazime dhe 28 humbje) dhe ka shënuar 5 gola.

Ergyn Ahmeti ishte pjesë e Prishtinës për tre edicione rresht, nga edicioni 2017/18, 2018/19 dhe ky i fundit

2019/20. Ahmeti ka zhvilluar 84 ndeshje zyrtare (35 zëvendësuar dhe 25 zëvendësues, duke shënuar 52 fitore, 18 barazime dhe 14 humbje), duke shënuar 9 gola, nga 3 gola për çdo sezon dhe ka asistuar në 5 gola.

Gjilani 'blindon' katër futbollistë, transferon Kelmendin

Skuadra e Gjilanit, e cila është shpallur nënkampione e Kosovës në futbollin e Kosovës, ka konfirmuar vazhdimin e kontratave me katër futbollistë. Bëhet fjalë për futbollistët Gerhard Progni, Fiton Hajdari, Tomislav Busiç dhe Keita Razak. "Sport Club 'Gjilani' njofton se ka arritur marrëveshje për ta zgjatur bashkëpunimin me sulmuesin Gerhard Progni edhe për një vit, si dhe me futbollistin Fiton Hajdari edhe për dy vjet. SC Gjilani konfirmon kështu të gjithë futbollistët e repartit sulmues edhe për edicionin e radhës,

pasi që futbollistët Tomislav Busiç dhe Keita Razak janë të lidhur me klubin edhe për një vit tjetër. Sulmi i ekipit ishte më efikas në gjithë Superligën e Kosovës në edicionin e fundit me 61 gola, prandaj drejtuesit e klubit janë angazhuar për t'i siguruar të gjithë futbollistët e këtij repartit edhe për edicionet e radhës", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Sport Club "Gjilani" ka arritur marrëveshje me futbollistin 25-vjeçar nga Prishtina, Shend Kelmendi. Përveç Prishtinës, futbollisti më i ri i Gjilanit karrierë kishte bërë edhe në disa skuadra të tjera në Kosovë dhe jashtë saj, ku vlen të ceket aventura e tij në klubin korçar KF Skënderbeu. Kelmendi, i cili në fushë luan si sulmues, në edicionin e fundit kishte luajtur për skuadrën e Flamurtarit, ku ka zhvilluar 24 takime, duke realizuar 10 gola dhe dhuruar një asistim për ish-bashkëlojtarët e tij në ekipin kuq e zi nga Prishtina. Kelmendi do të jetë futbollist i Gjilanit për dy vjetet e ardhshëm.

SHKURT

Fetahaj operohet me sukses

Skuadra e Ballkanit nga Suhareka ka njoftuar se futbollisti i spikatur Liridon Fetahaj është operuar me sukses. "Të dashur tifozë, ju njoftojmë se futbollisti ynë Liridon Fetahaj i është nënshtruar një intervenimi kirurgjik. Fatmirësisht, gjithçka ka shkuar mirë dhe Doni është duke e marrë veten. Është fjala për një shqetësim i cili në kohën e fundit ia ka pamundësuar që të jetë 100 % vetja siç të gjithë e njohim për depërtime të paparashikueshme. Klubi është me Liridonin gjatë gjithë kohës, duke e mbështetur në çdo formë. Urojmë që të rikuperohet sa më parë, duke e dribluar edhe këtë problem shëndetësor dhe duke e futur në harresë. Forca Liridon Fetahaj!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Kamberi prezantohet në Zvicër

Sulmuesi 25-vjeçar Florian Kamberi është transferuar përfundimisht nga skuadra skoceze Hiberian FC, tek ajo zvicerane, FC St. Gallen. Lojtari i kombëtares kuqezi ende në pritje të debutimit me të, ka nënshkruar një kontratë deri në verën e vitit 2023. Është rënë dakord mes palëve të mos zbulojnë modalitetet e transferimit por, sipas mediave skoceze, klubi nënkampion helvet ka paguar rreth 180 000 franga për shqiptarin.

Bilalli nënshkruan kontratë profesionale me Balikesisporin

I ka mjaftuar një vit me grupmoshat e reja U19, që Oltion Bilalli ta bindë klubin e Balikesisporit për të nënshkruar kontratë profesionale. Talenti gjilanas i dalë nga Shkolla e Futbollit Besëlidhja nënshkroi për dy vjet me klubin turk. "Kemi nënshkruar për dy vite + 1 me Oltion Bilallin e U-19", thuhet në njoftimin e klubit. Sulmuesi pritet që në edicionin e ardhshëm të jetë pjesë e skuadrës së parë të Balikesisporit. Ky klub garon në Ligën e Parë të Turqisë, rang i dytë elitë në këtë vend.

Një tjetër lojtar i Shkëndijës rezulton pozitiv me koronavirus

Nuk ka qetësi te Shkëndija e Tetovës për shkak të koronavirusit. Së fundmi, sipas asaj që zbulojnë mediat në Maqedoninë e Veriut, në klubin tetovar është zbuluar një rast pozitiv me koronavirus. Raportohet se lojtari i cili ka rezultuar pozitiv është një nga lojtarët e rinj i cili ka bërë testin e virusit dhe ka zbuluar se është pozitiv. Ky lajm te Shkëndija vjen vetëm pak ditë para nisjes së kampionatit, i cili është planifikuar të fillojë më 9 gusht dhe skuadra kuqezi do të përballet në derbi me Shkupin. Kujtojmë se te Shkëndija në fund të muajit maj u zbuluan edhe 2 raste të tjera me koronavirus dhe duket se virusi vazhdon të jetë i pranishëm në këtë skuadër.

Sanchezi nënshkruan me Interin kontratë trevjeçare

Interi ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit kilian Alexis Sanchez. Sanchez i është bashkuar Interit si lojtar i lirë, pasi e ka shkëputur kontratën me Manchester Unitedin. Ai ka nënshkruar kontratë me Interin deri në qershor të vitit 2023, ka njoftuar faqja zyrtare e klubit italian. Sanchez ishte huazuar tek Interi verën e kaluar dhe pati paraqitje të mira. Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka thënë se Interi është një destinacion i mirë për Sanchezin.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, me datë 07.08.2020, **SHPALLE:**

KONKURSI PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit (1 pozitë):

II. Numri i referencës: NPL -D.T. 07/08/20/2:

III. Detvat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësi të vijim: a) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit. Kur është e mundur siguron që artikujt e përdorimit të zakonshëm janë konsoliduar; b) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrë më ekonomike, efektive dhe të shpejta; c) Përfaqëson interesin e shtetit dhe siguron se ne specififikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë; d) Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit; e) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësië kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, specififikimet, Te Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet; f) Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit; g) Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve; h) Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta; i) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; j) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar; k) Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht; l) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në performim ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dështimet relevante të pranuar; m) Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e dhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave; n) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara. nj) Kryen punë dhe detyra tjera të urdhëruar nga Mbikëqyrtësi.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Letër motivuese;
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës nga (punëdhënësit, nga Trusti Pensional dhe nga ATK-ja);
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera;
- Certifikata e mjekut;
- Certifikata se keni zotësi të veprimit;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma e noterizuar e kualifikimit superior;
- Certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit e noterizuar;
- Tre (3) vjet përvojë pune në vendin e punës, zyrtarë përgjegjës i prokurimit;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;
- Njohuria obligative e kompjuterit.

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbvilljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



An EU Funded Project
Managed by the EU Office in Kosovo



Implemented by Hit Flores ShPK

Contract Title: Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels

Publication Reference: 1-2019/413-249

05 August 2020

Hit Flores Sh.P.K, with the address: Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo, intends to award the contract for: **Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels.**

All interested and qualified bidders, national and international, are invited to apply. The tender dossier is available from hit_flores@hotmail.com

The deadline for submission of bids is: **05 September 2020 at 15:00 hours local time** at the following address: Hit Flores Sh.P.K, Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 07-20

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit të cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fron të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në **adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për furnizim me pajisje të Tëknologjisë Informativë të OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (**vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €**).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **14.08.2020 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **17.08.2020 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **17.08.2020 ora 14:00.**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Krasniqi" Sh.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit: 70917890

► Sherif Ademi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Arbane

► Rushadje Ajazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur

► Aida Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ekrem Rexha " Lubizhd

► "3A ELEKTROSERVISI" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 601541958.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrlok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government
 Ministria e Punëve të Brendshme
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

KONKURS

Në bazë të Nenit 14 të Ligji Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, Ministria e Punëve të Brendshme shpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit – dy pozita.

Nga radhët e gjinisë femërore

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe Neni 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
 - në administrim të biznesit;
 - financa të korporatave;
 - financa publike ;
 - menaxhim thesari;
 - banka;
 - biznes konsultimesh;
 - industri ose
 - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në rast të numrit të lartë të aplikacioneve, kriteret e mëposhtme të dëshirueshme do të përdoren për të vlerësuar aplikacionet, me ç' rast kandidatët e pasuksesshëm do të eliminohen në fazën e shqyrtimit të CV-ve në procesin e rekrutimit:

Diplomë Bachelor

Diplomë Master,

Kualifikimi profesional pas –diplomimit,

Anëtarë i një shoqate profesionistësh të pranuar në nivel kombëtar

Përvoja e punës në institucione/projekte ndërkombëtare,

Përvoja e punës në pozitë drejtori ekzekutiv,

Aftësia për të folur dhe të shkruar rrjedhshëm një gjuhë të huaj.

KUSHTET

Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Ka qenë i dënuar dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose cilëso nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimuluës të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

AFTESITE PERSONALE TE KËRKUARA

- Udhëheqje
- Pune ekipore
- Përdorimi i internetit

- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

KOHËZGJATJA E MANDATIT:

Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshtim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zyra e Personelit, zyra nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 30 185.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit, përcaktohen nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik .

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Solar Energy Group Europe” Sh.p.k Vitomericë, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore -150MW në Bec dhe Vraniq komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.08.2020 në ora 10:00 në hapësirat e hotel “Pashtrikut” rruga “Nënë Tereza” në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania “Solar Energy Group Europe” Sh.p.k Vitomericë, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore -150MW në Bec dhe Vraniq komuna e Gjakovës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/8519814188?pwd=VW1jbHQvSFNXMFBIUkJObVI2MFJjQT09>

Meeting ID: 851 981 4188

Passcode: MrV6Wy

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

KONKURS

Na osnovu člana 14. Zakona br. 05/L - 085 o električnoj energiji, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova objavljuje konkurs za ovo radno mesto:

Naziv radnog mesta:

Direktor odbora operatera prenosnog sistema -dve pozicije iz redova ženskog pola

KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNA PODOBNOST

Da bi jedan kandidat bio izabran za direktora Odbora u Centralnom javnom preduzeću, mora imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i člana 9. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i to:

- Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva na visokom nivou upravljanja u sledećim oblastima:
 - u poslovnoj administraciji;
 - korporativnim finansijama;
 - javnim finansijama;
 - upravljanje trezorom;
 - banke;
 - poslovnim konsultacijama;
 - industriji ili
 - da je radio najmanje 5 godina kao ovlašćeni računovođa, kvalifikovani pravnik, ili kvalifikovani član bilo koje druge profesije koja je povezana za poslovnu delatnost Centralnih javnih preduzeća.

U slučaju velikog broja aplikacija, sledeći poželjni kriterijumi biće korišćeni za procenu aplikacija, pri čemu neuspešni kandidati biće eliminisani u fazi razmatranja biografija u procesu regrutovanja:

Diploma osnovnih studija
Diploma master studija,
Postdiplomske profesionalne kvalifikacije,
Član nacionalno priznatog profesionalnog udruženja
Radno iskustvo u međunarodnim institucijama/projektima,
Radno iskustvo na položaju izvršnog direktora,
Sposobnost da tečno govori i piše jedan strani jezik.

USLOVI

Osoba nema pravo vršenja funkcije direktora u Odboru centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Bio osuđen ili je pod istragom nadležnog suda;
- Prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, osim ako je ta kazna preinačena od strane suda ili drugog žalbenog organa;
- Lažno svedočio pod zakletvom;
- Bio na rukovodećoj funkciji u kompaniji koja je bankrotirala tokom poslednjih deset (10) godina.
- Ne radi u bilo kojoj instituciji koja kreira razvojne politike za Javna preduzeća kod kojih kandidat aplicira.

Kandidat ne može biti izabran za direktora Odbora centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:

- Trenutno je službenik, menadžer dotičnog Javnog preduzeća, (u smislu člana 21. Zakona o javnim preduzećima), ili bilo koje od njenih filijala;
- Služio kao službenik ili menadžer dotičnog Javnog preduzeća, ili bilo koje od njenih filijala, tokom proteklih pet (5) godina;
- Trenutno, ili tokom proteklih tri godina, se nalazi u bilo kakvim materijalnim poslovnim odnosima (osim kao individualni korisnik usluga Javnih preduzeća) sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala, bilo da je to direktno ili indirektno;
- Akcionar, direktor ili službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu, koji ima materijalne poslovne odnose sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala;
- Prima, ili je primao tokom prethodne tri (3) godine, dodatnu kompenzaciju od dotičnog Javnog preduzeća ili od bilo koje od njenih filijala (osim honorara za direktora ili stimulative kompenzacije utvrdene članom 20.1 Zakona o javnim preduzećima), ili je član penzione šeme dotičnog javnog preduzeća ili bilo koje njene filijale;
- Predstavlja akcionara koji poseduje više od deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u dotičnom Javnim preduzeću;
- Služio u Odboru direktora dotičnog Javnog preduzeća više od devet (9) godina od datuma njegovog/njenog prvog izbora;
- Rođak u trećem kolenu (kao što je utvrđeno u skladu sa definicijom "Finansijskog interesa" u članu 2. Zakona o javnim preduzećima) bilo koje osobe koja pripada nekoj od gore navedenih kategorija.
- Službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u privrednom društvu koje konkuriše sa Preduzećem, ili je viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar (koji poseduje više od dva odsto (2%) prava glasa), ili ima značajan finansijski interes u bilo kom od privrednih društva koje konkurišu sa Preduzećem;
- Trenutno, ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma apliciranja, bio je javno izabrani zvaničnik, politički imenovan ili nosilac rukovodeće funkcije ili donosilac odluka u političkoj stranci;
- Ima bilo kakav sukob interesa koji bi po prirodi prouzrokovao da ova osoba ne bude u stanju da rutinski, pouzdano, nezavisno i objektivno ispunjava svoje finansijske obaveze prema akcionarima i javnim preduzećima.

POTREBNE LIČNE SPOSOBNOSTI

- Liderstvo
- Timski rad

- Korišćenje interneta
- Strateško razmišljanje
- Orijentisanje na rezultate
- Odlučivanje
- Uticajne sposobnosti
- Jasnu koherentnost, koncizna komunikacija
- Integritet
- Svest
- Kreativno razmišljanje

TRAJANJE MANDATA:

Mandat svakom članu Odbora traje četiri (4) godine, uz mogućnost imenovanja na još jedan mandat. Mandat svakom članu Odbora počinje od dana imenovanja od strane Skupštine Republike Kosovo.

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA ZA KONKURISANJE

Kandidati za direktore u Odboru javnog preduzeća moraju dostaviti sledeća dokumenta (Neuspeh dostavljanja sledećih dokumenata rezultiraće odbacivanjem aplikacije):

- Biografija u kojoj su navedeni primeri uspeha u radu
- Motivaciono pismo
- Izjavu pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije)
- Dokumentacija predviđena prema uslovima za zapošljavanje (potvrde o profesionalnoj kvalifikaciji, radnom iskustvu)
- Sertifikat (potvrdu) koji dokazuje da nije pod istragom
- Državljanin Kosova (kopiju pasoša ili lične karte).

Podnosilac aplikacije mora lično popuniti izjavu pod zakletvom prilikom apliciranja, u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti. Svako materijalno lažno predstavljanje, bilo da je to namerno ili nenamerno, ili materijalna promena od datih informacija u gore navedenoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Dokumentacija treba da bude dostavljena u zapečaćenoj koverti na kojoj treba napisati ime i prezime kao i naziv Javnog preduzeća u kojoj kandidat konkuriše i dostaviti Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, kadrovskoj službi, kancelarija br. 320, sprat III, zgrada Palate štampe, Priština, ili putem elektronske pošte na linku: <http://map.rks-gov.net>
Dostavljena dokumentacija se ne vraća. Originali su potrebni tokom intervjua.

Za dodatne informacije pozovite na broj telefona 038/ 200 30 185.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su izabrani za intervju.

Iznos za naknadu članova Odbora utvrđuje Skupština do donošenja odgovarajućeg Zakona o platama visokih javnih funkcionera.

Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L